



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.legjislacioni.gov.al](http://www.legjislacioni.gov.al)

**Nr. 109**

**Datë 11 korrik 2014**

## P Ë R M B A J T J A

|                                    |  | Faqe |
|------------------------------------|--|------|
| Ligj nr. 60/2014<br>datë 19.6.2014 | Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.....  | 4205 |
| Ligj nr. 61/2014<br>datë 19.6.2014 | Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin | 4216 |
| Ligj nr. 62/2014<br>datë 19.6.2014 | Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për shmangien e tatimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal   | 4228 |

**LIGJ**  
**Nr. 60/2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10448,**  
**DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT",**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Shtojca 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

**SHTOJCA 1**

**LEJET E MJEDISIT TË TIPAVE A, B DHE C NË VARËSI TË KAPACITETIT PRODHUES KUFI**

**SHËNIME PËR TABELËN E VEPRIMTARIVE TË TIPIT A**

Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. Në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti **kufi** nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

|                               | <b>ID</b> | <b>Veprimtaria</b>  | <b>Kapaciteti kufi për lejet e Tipit A</b>                          | <b>Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B</b>         | <b>Kapaciteti kufi për lejet e Tipit C</b> |
|-------------------------------|-----------|---|---|--|--|
| <b>Industritë energjetike</b> | 1.1       | Instalimet me djegie  | Energjia termike në hyrje është e barabartë ose më e madhe se 50 MW | Inputi (energji) termike është më e vogël se 50 MW | -----                                      |
|                               | 1.2       | Rafineritë e vajrave dhe gazeve minerare  | Të gjitha instalimet  | -----  | -----                                      |
|                               | 1.3       | Furrat e koksit   | Të gjitha instalimet  | -----  | -----                                      |
|                               | 1.4       | Instalimet e gazifikimit dhe lëngëzimit të qymyrit  | Të gjitha instalimet  | -----  | -----                                      |
|                               | 1.5       | Kërkimi i naftës dhe i gazit natyror  | Të gjitha instalimet  | .....  |  |
|                               | 1.6       | Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror   | Të gjitha instalimet  | -----  | -----                                      |
|                               | 1.7       | Gaz natyror aromatik ose GNL përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me Tipin A, ose përzierje e aromave  | -----   | Të gjitha instalimet                               | -----                                      |
|                               | 1.8       | Përzierje aromash për t'u përdorur me gazin natyror ose naftën e lëngështuar  | -----   | Të gjitha instalimet                               | -----                                      |
|                               | 1.9       | Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj:<br>a. Magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisterna të palëvizshme në ndonjë terminal, ose ngarkim/shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në/nga një cisternë e lëvizshme, cisternë | -----   | Të gjitha instalimet                               |  |

|  |      |   |  |   |   |
|--|------|---|--|---|---|
|  |      | hekurudhore ose anije e ujërave të brendshme në terminal.<br>b. Shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant. |  |   |   |
|  | 1.10 | Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant.  | -----  | -----   | Të gjitha instalimet                              |
|  | 1.11 | Furnizim për mbushje gazi GLN   |  | Kapacitet mbi 10 m3   | Kapaciteti i barabartë me 10 m3 ose më pak se kaq |
| <b>Prodhimi dhe përpunimi i metaleve</b> | 2.1  | Pjekja ose aglomerimi i xeherorëve metalikë (përfshirë xeherorët sulfurë)   | Të gjitha instalimet   | -----   | -----   |
|  | 2.2  | Prodhim i gizës ose çelikut (shkrijë primare dhe sekondare) duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme   | Kapaciteti prodhues është më i madh se 2,5 tonë/orë  | Kapaciteti prodhues është i barabartë me 2,5 tonë/orë ose më i vogël se kaq   | -----   |
|  | 2.3  | a. Përpunim i metaleve ferrose - me mullinj me rula në të nxehtë  | Kapaciteti prodhues është më i madh se 20 tonë çelik bruto në orë  | Kapaciteti prodhues është i barabartë me 20 tonë çelik bruto në orë ose më i vogël se kaq   | -----   |
|  |      | b. Përpunim i metaleve ferrose - me farkëtim  | Energjia është më e madhe se 50 kilojoule për goditës, dhe fuqia kalorifike është më e madhe se 20 MW                                    | Energjia është e barabartë me 50 kilojoule për goditës ose më pak se kaq, dhe fuqia kalorifike është e barabartë me 20 MW ose më pak se kaq     | -----   |
|  |      | c. Përpunim i metaleve ferrose - dhe aplikimi i veshjes me metal të shkrire   | Furnizimi i procesit me materiale është më i madh se 2 tonë/orë çelik bruto  | Hyrja është e barabartë me 2 tonë/orë çelik bruto ose më pak se kaq   | -----   |
|  | 2.4  | Fonderitë e metaleve ferrose  | Kapaciteti prodhues është më i madh se 20 tonë/ditë  | Kapaciteti prodhues është i barabartë me 20 tonë/ditë ose më pak se kaq   | -----   |
|  | 2.5  | a. Prodhim bruto i metaleve me ngjyrë nga xeherorët, nga koncentratet ose lëndë të para dytësore nga procese metalurgjike, kimike ose elektrolitike               | Të gjitha instalimet   | -----   | -----   |
|  |      | b. Shkrijja dhe përftimi i aliazheve të metaleve jo-ferrose (me ngjyrë) përfshirë produktet e rikuperuara (duke përfshirë rafinimin dhe derdhjen në fonderi)      | Kapaciteti shkrire është më i madh se 4 tonë/ditë për plumbin ose kadmiumin, ose më i madh se 20 tonë/ditë për të gjitha metalet e tjera | Kapaciteti shkrire është i barabartë me 4 tonë/ditë për plumbin ose kadmiumin ose më pak se kaq, ose 20 tonë/ditë për të gjitha metalet e tjera | -----   |
|  | 2.6  | Trajtime sipërfaqësore të metaleve dhe plastikave duke përdorur procese elektrolitike ose kimike  | Volumi i depozitës së trajtimit më i madh se 30 m3   | Volumi i depozitës së trajtimit është i barabartë me 30m3 ose më pak se kaq   | -----   |
| <b>Industria minerare</b>                | 3.1  | a. Prodhimi i klinkerit të çimentos në furra rrotulluese  | Kapaciteti prodhues është më i madh se 500 tonë/ditë   | Kapaciteti prodhues është i barabartë me 500 tonë/ditë ose më pak se kaq  | -----   |
|  |      | b. Prodhim i gëlqeres në furra rrotulluese  | Kapaciteti prodhues është më i madh se 50 tonë/ditë  | Kapaciteti prodhues është i barabartë me 50 tonë/ditë ose më pak se kaq   | -----   |
|  |      | c. Prodhim i klinkerit të çimentos ose gëlqeres në furra të tjera   | Kapaciteti prodhues është më i madh se 50 tonë/ditë  | Kapaciteti prodhues është i barabartë me 50 tonë/ditë ose më pak se kaq   | -----   |
|  |      | d. Magazini, ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe i çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe                        | -----  | -----   | Të gjitha instalimet                              |
|  |      | e. Përzjerja e çimentos ose përdorimi i çimentos në   | -----  | Të gjitha instalimet  | -----   |

|     |  |  |   |       |  |
|-----|--|--|---|-------|--|
|     |  | masë të madhe, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzjerjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos |   |       |  |
| 3.2 | a. Prodhim i asbestit ose i produkteve me bazë asbesti   | Të gjitha instalimet   | -----   | ----- |  |
|     | b. Prodhim i produkteve me bazë asbesti  | Të gjitha instalimet   | -----   | ----- |  |
|     | c. Nxjerrje e asbestit nga mjetet e transportit hekurudhor, me përjashtim të rasteve:<br>(i) gjatë riparimit ose mirëmbajtjes së makinerisë;<br>(ii) gjatë operacioneve të rikuperimit pas një aksidenti, ose<br>(iii) në rastet kur asbesti është mbuluar përgjithnjë me çimento ose ndonjë material tjetër (përfshirë plastikën, gomën ose rrëshirën)  | -----  | Të gjitha instalimet  | ----- |  |
|     | d. shkatërrimi i mjeteve të transportit hekurudhor përmes djegies kur asbesti është i inkuorporuar ose është shpërndarë në gjithë strukturën e tij.  | -----  | Të gjitha instalimet  | ----- |  |
|     | e. Lustrimi industrial duke përfshirë gdhendjen, shpimin ose montimin e produkteve të prodhuara prej asbesti, ose ndonjërit nga produktet e mëposhtme që nuk janë të lidhura me prodhimin –<br>(i) filtrat prej asbesti<br>(ii) produktet e fërkimit prej asbesti<br>(iii) lidhjet, paketimet dhe materialet e përforcimit prej asbesti;<br>(iv) paketimet prej asbesti;<br>(v) tekstilet prej asbesti | -----  | Të gjitha instalimet  | ----- |  |
| 3.3 | Prodhimi i qelqit dhe fibrave të qelqit  | Kapaciteti shkrirës është më i madh se 20 tonë/ditë  | Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 tonë/ditë ose më pak se kaq   | ----- |  |
| 3.4 | a. Shkrirje e substancave minerare   | Kapaciteti shkrirës është më i madh se 20 tonë/ditë  | Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 tonë/ditë ose më pak se kaq   | ----- |  |
|     | b. Prodhimi i substancave minerare   | Kapaciteti shkrirës është më i madh se 20 tonë/ditë  | Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 tonë/ditë ose më pak se kaq   | ----- |  |
| 3.5 | a. Prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit  | Kapaciteti prodhues është më i madh se 75 tonë/ditë, dhe/ose kapaciteti i furrës është më i madh se 4 m3 dhe me densitet vendosje që është më i madh se 300 kg/m3 për çdo furrë              | Kapaciteti prodhues është i barabartë me 75 tonë/ditë ose më pak se kaq, dhe/ose kapaciteti i furrës është i barabartë me 4 m3 ose më pak se kaq dhe me densitet vendosje për çdo furrë që është i barabartë me 300 kg/m3 ose më pak se kaq | ----- |  |
|     | b. Pjekje e produkteve prej argjile të rëndë ose produkte zjarrduruese,  | -----  | Të gjitha instalimet  | ----- |  |

|                             |      |  |  |  |                           |
|-----------------------------|------|--|--|--|---------------------------|
|                             |      | përveç produkteve prej argjile të rëndë në një furrë ku veprimtaria nuk përfshihet në përshkrimin e kategorisë 3.5 a më lart                               |  |  |                           |
|                             |      | c. Lustrim me avull të produkteve prej balte (poçeri/qeramikë) ose prej argjile me kripëra   | -----  | Të gjitha instalimet   | -----                     |
|                             | 3.6  | Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to  | -----  | Të gjitha instalimet   | -----                     |
|                             | 3.7  | Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret   | -----  | Të gjitha instalimet   | -----                     |
|                             | 3.8  | Gërmimet nën ujërat bregdetare ose ujërat sipërfaqësore kontinentale   |  | Të gjitha instalimet   | -----                     |
|                             | 3.9  | Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit  | -----  | -----  | Të gjitha instalimet      |
|                             | 3.10 | Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike   | -----  | Të gjitha instalimet   | -----                     |
| <b>Industria kimike (1)</b> | 4.1  | Prodhimi i kimikateve organike bazë(2)   | Të gjitha instalimet   | -----  | -----                     |
|                             | 4.2  | Prodhimi i kimikateve inorganike bazë(3)   | Të gjitha instalimet   | -----  | -----                     |
|                             | 4.3  | Prodhim i plehëruesve me bazë fosfori-azoti ose potasiumi (plehërues të thjeshtë apo të përzier).  | Të gjitha instalimet   | -----  | -----                     |
|                             | 4.4  | Prodhim i produkteve bazë për shëndetin e bimëve dhe të biocidëve.   | Të gjitha instalimet   | -----  | -----                     |
|                             | 4.5  | Prodhim i produkteve farmaceutike bazë me anë të proceseve kimike ose biologjike   | Të gjitha instalimet   | -----  | -----                     |
|                             | 4.6  | Prodhim i eksplozivëve   | Të gjitha instalimet   | -----  | -----                     |
|                             | 4.7  | Magazini i kimikateve, përveçse kur paraqiten si pjesë e ndonjë veprimtarie tjetër të Tipit A ose Tipit B dhe përveç ndodhjes në një cisternë të lëvizshme | -----  | I barabartë ose më i madh se limitet e mëposhtme:<br>Secili ose disa prej akriloidëve 20 tonë;<br>Akrilonitrilet 20 tonë;<br>Amoniak anhidrid prej 100 tonë;<br>Fluorur hidrogjeni anhidrid 1 ton;<br>Toluen di-isocianati 20 tonë;<br>Monomer klorid vinyl 20 tonë;<br>Etilene 8000 tonë. | Poshtë limitit të Tipit B |
| <b>Menaxhimi i mbetjeve</b> | 5.1  | a. Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi  | Të gjitha instalimet   | -----  | -----                     |
|                             |      | b. Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a                               | Instalimi i incinerimit përdoret ose është disenuar për të djegur mbetje me intensitet më shumë se 1 ton/orë | Instalimi i incinerimit përdoret ose është disenuar për të djegur mbetje me intensitet të barabartë me 1 ton/orë ose më pak se kaq   | -----                     |

|      |  |  |  |                      |
|------|--|--|--|----------------------|
| 5.2  | a. Lendfilli i mbetjeve (D1) duke përfshirë lëndfillin e mbetjeve inerte   | Kapaciteti i depozitimit është më i madh se 10 tonë/ditë ose kapaciteti i disenjuar i lëndfillit është më i madh se 25 000 tonë. | Kapaciteti depozitues është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak se kaq ose kapaciteti i disenjuar i lëndfillit është 25 000 tonë ose më pak se kaq. | -----                |
|      | b. Lendfill i mbetjeve inerte  | -----  | Të gjitha instalimet   | -----                |
| 5.3  | a. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2 a)  | Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 tonë/ditë  | Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak se kaq  | -----                |
|      | b. Asgjësimi i vajrave të përdorura përveç incinerimit (5.1 a) ose lëndfillimit (5.2 a)  | Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 tonë/ditë  | Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak se kaq  | -----                |
|      | c. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim biologjik (D8)   | Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 tonë/ditë  | Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 tonë/ditë ose më pak se kaq  | -----                |
|      | d. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim fiziko – kimik (D9)  | Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 50 tonë/ditë  | Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 tonë/ditë ose më pak se kaq  | -----                |
|      | e. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me metoda të tjera përveç (D1), (D8) ose (D9)   | -----  | Të gjitha instalimet   | -----                |
| 5.4  | a. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R1, R5, R6, R8, ose R9  | Të gjitha instalimet   | ----   | -----                |
|      | b. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10  | -----  | Të gjitha instalimet   | ----                 |
|      | c. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme   | ----   | Të gjitha instalimet   | -----                |
| 5.5  | Magazininim i hekurishteve/ skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme   | ----   | ----   | Të gjitha instalimet |
| 5.6  | a. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren   | -----  | ----   | Të gjitha instalimet |
|      | b. Magazininim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a  | ----   | ----   | Të gjitha instalimet |
| 5.7  | Magazininim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE)   | ----   | Të gjitha instalimet   | ----                 |
| 5.8  | Magazininim, rikuperim i hekurishteve/ skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave   | -----  | Të gjitha instalimet   | -----                |
| 5.9  | Magazininim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontenierët ose nga larjet e kontenierëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë | -----  | Të gjitha instalimet   | -----                |
| 5.10 | a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart   | -----  | Të gjitha instalimet   | -----                |
|      | b. Stacion transferimi për   | -----  | -----  | Te gjitha instalimet |

|  |      |  |  |  |   |
|--|------|--|--|--|---|
|  |      | mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart   |  |  |   |
|  | 5.11 | Kompostim i mbetjeve bio   | -----  | Kapaciteti i kompostimit më i madh se 50 tonë                            | Kapaciteti i kompostimit është i barabartë me 50 tonë ose më pak se kaq |
| <b>Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza</b>                  | 6.1  | Instalim trajtimi për ujërat e ndotura urbane  | -----  | Të gjitha instalimet   | -----   |
|  | 6.2  | Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen  | -----  | Të gjitha instalimet   | -----   |
|  | 6.3  | Përdorimi i llumit të ujërave të zeza në tokë  | -----  | Të gjitha instalimet   | -----   |
|  | 6.4  | Magazininim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke përfshirë<br>- llumin nga ujërat e ndotura urbane<br>- llumin e cisternave septike<br>- mbetjet e ujërave të zeza nga gropa të hapura<br>- mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujërave të zeza | -----  | -----  | Të gjitha instalimet  |
| <b>Veprimtaritë e prodhimit të letres, pulpës dhe dërrasës</b> | 7.1  | a. Prodhim i pulpës nga trungjet e drurit dhe materiale të tjera fibroze   | Të gjitha instalimet                                 | -----  | -----   |
|  |      | b. Prodhim i letres dhe ose i karbonit   | Kapaciteti prodhues është më i madh se 20 tonë/ditë  | Kapaciteti prodhues është i barabartë me 20 tonë/ditë ose më pak se kaq  | -----   |
|  |      | c. Prodhim i dërrasës me ristela dhe me fibra, kompresatës ose me çdo përbërje tjetër me bazë druri  | -----  | Të gjitha veprimtaritë   | -----   |
| <b>Veprimtaritë e karbonit</b>                                 | 7.2  | Prodhim i karbonit ose qymyrit që digjet me vështirësi me anë të djegies ose grafitizimit  | Të gjitha instalimet                                 | -----  | -----   |
| <b>Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit</b>                  | 7.3  | a. Distilim i katranit ose i bitumit në lidhje me ndonjë proces prodhimi   | -----  | Të gjitha instalimet   | -----   |
|  |      | b. Ngrohjen e katranit për prodhimin e elektrodave ose materialeve refraktare me bazë karboni  | -----  | Të gjitha instalimet   | -----   |
|  |      | c. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3 a ose 7.3 b ose në pika të tjera të kësaj shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi   | -----  | Të gjitha instalimet   | -----   |
|  |      | d. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3 a ose 7.3 b ose në pika të tjera të kësaj shtojce, që përfshijnë oksidimin e bitumit, duke fryrë ajër përmes saj, në fabrikën ku nuk kryhet asnjë nga aktivitetet e përshkruara në ndonjë seksion të kësaj shtojce.           | -----  | Të gjitha instalimet   | -----   |
| <b>Përpunimi i tekstileve ose fibrave</b>                      | 7.4  | Fabrika për trajtimin paraprak ose ngjyrosjen e tekstileve dhe fibrave (veprime të tilla si larje, zbardhje, mercerizim)   | Kapaciteti përpunues është më i madh se 10 tonë/ditë | Kapaciteti përpunues është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak se kaq | -----   |
| <b>Përpunimi i gëzofit</b>                                     | 7.5  | Instalime për krehjen dhe lyerjen e gëzofëve   | -----  | Kapaciteti përpunues është më i madh se 10 tonë/ditë                     | Kapaciteti trajtues është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak se kaq |

|  |       |   |   |   |   |
|--|-------|---|---|---|---|
| <b>Trajtimet me regjije dhe prodhimi i lëkurës</b>                             | 7.6   | a. Regjija e lëkurëve të papunuara dhe shollave   | Kapaciteti trajtues është më i madh se 12 tonë/ditë produkt të përfunduar   | Kapaciteti përpunues është i barabartë me 12 tonë/ditë produkt të përfunduar ose më pak se kaq  | -----   |
|  |       | b. Prodhime të produkteve të lëkurës përveç rastit kur është pjesë e një veprimtarie tjetër në këtë shtojcë   | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |
| <b>Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to</b>        | 7.7   | a. Thertore   | Kapaciteti prodhues i karkasave është më i madh se 50 tonë/ditë   | Kapaciteti prodhues i karkasave është i barabartë me 50 tonë/ditë ose më pak se kaq, por gjithsesi më shumë se 5 tonë/ditë  | Kapaciteti prodhues i karkasave është i barabartë me 5 tonë në ditë ose më pak se kaq.          |
|  |       | b. Asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve, me mënyra të tjera përveç shndërrimit ose incinerimit, të përmendura në ndonjë veprimtari tjetër të kësaj shtojcë. | Kapaciteti i trajtimit është më i madh se 10 tonë/ditë të karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë                   | Kapaciteti i trajtimit është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak se kaq karkasa të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë.   | -----   |
|  |       | c. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët (përveç qumështit)   | Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 75 tonë në ditë  | Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 75 tonë në ditë ose më pak se kaq, por më shumë se 5 tonë/ditë   | Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 5 tonë/ditë ose më pak   |
|  |       | d. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e produkteve ushqimore nga lëndët e para vegjetale   | Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 300 tonë në ditë (vlerë mesatare duke u bazuar në të dhëna trimestrale). | Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 300 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat trimestrale), por më shumë se 10 tonë/ditë. | Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak. |
|  |       | e. Trajtimi dhe përpunimi i qumështit   | Sasia e qumështit në hyrje është më e madhe se 200 tonë/ditë (vlerë mesatare bazuar në të dhëna vjetore).                                     | Sasia e qumështit në hyrje është e barabartë me 200 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat vjetore), por më shumë se 2 tonë/ditë.                             | Sasia e qumështit në hyrje është e barabartë me 2 tonë/ditë ose më pak se kaq.                  |
|  |       | f. Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve  | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |
|  |       | g. Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike  | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |
|  |       | h. Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike duke përfshirë fabrikat e birrës   | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |
|  |       | i. Prodhim i produkteve të frutave  | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |
|  |       | j. Prodhim i xhelatinës dhe i materialeve ngjitëse nga lëkurat dhe kockat   | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |
|  |       | k. Prodhimi i produkteve të duhanit   | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |
|  |       | l. Prodhim i ushqimit për kafshë  | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |
|  |       | m. Furra të prodhimit të bukës  | -----   | -----   | Të gjitha instalimet  |
| n. Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme | ----- | -----   | Të gjitha instalimet  |   |   |
| o. Magazinimi frigoriferik i produkteve ushqimore të ambalazuara               |       |   | Për magazina frigoriferike me kapacitet magazinues mbi 20 tonë  |   |   |
| <b>Blegtoria</b>   | 7.8   | a. Rritje intensive e shpendëve në një instalim   | Më shumë se 40000 (krerë) vende shpendësh   | 40000 - 1000 (krerë) vende shpendësh  | Barabartë me 1000 (krerë) vende shpendësh ose më pak se kaq                                     |



|   |     |   |   |   |   |
|---|-----|---|---|---|---|
|   |     | b. Rritje intensive e derrave në një instalim   | Më shumë se 2000 (kokë) vende për derra me peshë mbi 30 kg                      | 2000 – 200 (kokë) vende për derra me peshë mbi 30 kg  | Barabartë me 200 (kokë) vende ose më pak se kaq për derra me peshë mbi 30 kg  |
|   |     | c. Rritje intensive e derrave në një instalim   | Më shumë se 750 (kokë) vende për dosa   | 750 – 100 (kokë) vende për dosa   | Barabartë me 100 (kokë) vende për dosa ose më pak se kaq  |
|   |     | d. Rritje intensive e gjedhit në një instalim   | -----   | Më shumë se 50 (njësi) vende gjedhi   | Barabartë me 50 (njësi) vende gjedhi ose më pak se kaq  |
|   |     | e. Rritje intensive e kafshëve të tjera, të cilat nuk janë përmendur më lart  | -----   | Bazuar në mënyrën e konvertimit të kafshëve të tjera në njësi gjedhi (me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave)   | Bazuar në mënyrën e konvertimit të kafshëve të tjera në njësi gjedhi (me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave) |
|   |     | f. Vendet e tregtimit të kafshëve   | -----   | -----   | Të gjitha rastet  |
| <b>Veprimtaritë e mbulimit të sipërfaqes dhe të stampimit</b> | 7.9 | a. Instalimet për trajtimin e sipërfaqes së substancave, objekteve ose produkteve duke përdorur tretës organikë, në mënyrë të veçantë për t'i krehur, stampuar, veshur me cipë, zhvajosur, mbrojtur nga uji, kalibruar, lyer, pastruar ose regjur/ngopur/lagur në thellësi  | Kapaciteti konsumues është më shumë se 150 kg/orë ose më shumë se 200 tonë/vit. | Kapaciteti konsumues është 150 kg/orë ose më pak ose 200 tonë/vit ose më pak se kaq.  | -----   |
|   |     | b. Aplikimi ose heqja e materialeve veshëse që përbajnë ndonjë përbërës tributyltin ose triphenyltin, nqs ndodhet në kantier detar  | -----   | Kantier detar ku anijet me një gjatësi prej 25 m ose më shumë mund të ndërtohen, mirëmbahen ose riparohen   | -----   |
|   |     | c. Riparim ose ri-sprucim i avionëve ose mjeteve të transportit hekurudhor ose pjesëve të tyre  | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |
|   |     | d. Ringjyrosje ose risprucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre  | -----   | Ka gjasa që në çdo periudhë 12 mujore veprimtaria të përdorë 1 ton solvente organike  | Çdo veprimtari e ngjashme me përdorim materialesh nën limitin e Tipit B   |
|   |     | e. Përveç rasteve të përmendura në 7.9 c dhe 7.9 d, çdo proces (duke përfshirë ri-ngjyrosjen ose ri-sprucimin plotësisht ose pjesërisht të avionëve, mjeteve të transportit hekurudhor ose rrugor) për aplikime mbi nënshtresat ose që bën tharjen, ose kujdeset pas këtyre aplikimeve, stampon me bojë ose ngjyros ose aplikon çdo material tjetër veshës si një veprimtari prodhimi ose gjatë veprimtarisë së prodhimit | -----   | Ka gjasa që në çdo periudhë 12- mujore veprimtaria të përdorë:<br>i. 20 tonë ose më shumë bojë stampimi, ngjyrosje ose material tjetër veshës që aplikohet në trajtë të ngurtë;<br>ii. 20 tonë ose më shumë për çdo veshje metali që sprucohet në trajtë të shkrirë<br>iii. 25 tonë ose më shumë solucione organike për çdo lloj aktiviteti ofset në të ftohtë, ose veprimtari printimi ofset me fletë, ose<br>iv. 5 tonë ose më shumë për çdo veprimtari që nuk është përmendur në nënparagrafin (iii) | Çdo veprimtari e ngjashme me përdorim materialesh nën limitin e Tipit B   |
|   |     | f. Përveç rasteve të përmendura në Tipin A të kësaj shtojce, prodhimi ose formulimi i bojës së stampimit ose të çdo materiali tjetër veshës që  | -----   | Të gjitha instalimet  | -----   |

|   |      |   |       |   |   |
|---|------|---|-------|---|---|
|   |      | përmban ose përfshin përdorimin e substancave organike  |       |   |   |
|   |      | g. Përveç rasteve të përmendura në Tipin A të kësaj shtojce, prodhimi i pluhurit si material veshës   | ----  | Të gjitha instalimet  | -----   |
| Veprimtaritë e lëndës së drurit                           | 7.10 | a. Kujdesja ose tretja kimike e lëndëve të drurit, si pjesë e procesit të prodhimit, ose prodhime të përbëra tërësisht ose kryesisht nga druri  | ----  | Të gjitha instalimet  | ----  |
|   |      | b. Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri nëq veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit. | ----  | Ka gjasa që në çdo periudhë 12- mujore rezultati i veprimtarisë të jetë:<br>i. 10 000 m <sup>3</sup> kur druri vetëm sharrohet<br>ii. 1 000 m <sup>3</sup> në çdo rast tjetër | Çdo veprimtari e ngjashme me përdorim materialesh nën limitin e Tipit B   |
| Veprimtaritë e gomës                                      | 7.11 | a. Prodhimi i gomave të reja për makinat (por duke mos përfshirë riderdhjen dhe riveshjen)  | ----- | Të gjitha instalimet  | -----   |
|   |      | b. Përveç rasteve të përmendura në ndonjë nga veprimtaritë e Tipit A në këtë shtojcë, trazimi, bluarja ose përzierja e:<br>i. gomës natyrale ose<br>ii. elastomereve me përbërje sintetike organike, nëq është përdorur karboni i zi  | ----  | Të gjitha veprimtaritë  | ----  |
|   |      | c. Riderdhja dhe riveshja e gomave  | ----  | Të gjitha instalimet  | -----   |
| Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve | 7.12 | a. Procesi i tharjes së shpejtë të bojës së stampimit/printimit me anë të ajrit të nxehtë   | ----  | Konsumi i solventëve është më i madh se 15 tonë/vit   | Konsumi i solventëve është i barabartë me 15 tonë/vit ose më pak se kaq   |
|   |      | b. Publikimi i materialeve me atë të procesit rotogravurë   | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 25 tonë/vit   | Konsumimi i solventëve është i barabartë me 25 tonë/vit ose më pak se kaq |
|   |      | c. Procese të tjera rotogravurë, flexografi, stampim/printim me makinë shtypi rotativë, laminim ose lustrim.  | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 15 tonë/vit   | Konsumi i solventëve është i barabartë me 15 tonë/vit ose më pak se kaq   |
|   |      | d. Stampim/printim me makinë shtypi rotativë mbi tekstil /karton  | ----  | Të gjitha instalimet  | -----   |
|   |      | e. Pastrim i sipërfaqes duke përdorur substanca ose preparate që për shkak të përbërjes së tyre të avullueshme, klasifikohen si kancerogjene, mutagjeneve ose toksike për riprodhimin   | ----  | Të gjitha instalimet  | -----   |
|   |      | f. Pastrues të tjerë sipërfaqesh  | ----  | Të gjitha instalimet  | -----   |
|   |      | g. Lyerja dhe lustrimi i makinave   | ----  | Të gjitha instalimet  | -----   |
|   |      | h. Lyerja/veshja e bobinave   | ----  | Të gjitha instalimet  | -----   |
|   |      | i. Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë ato   | ----  | Të gjitha instalimet  | -----   |

|   |      |  |       |  |  |
|---|------|--|-------|--|--|
|   |      | të metalit, plastikës, tekstileve (me përjashtim të stampimit/printimit me makinë shtypi rotativë të tekstileve), pëlhurave, filmit dhe letrës |       |  |  |
|   |      | j. Veshje e telave spirale   | ----  | Të gjitha instalimet   | -----  |
|   |      | k. Veprimtaritë e lyerjes/veshjes të aplikuar në sipërfaqe druri   | ----  | Të gjitha instalimet   | -----  |
|   |      | l. Pastrimi kimik  | ----- | -----  | Të gjitha instalimet   |
|   |      | m. Procesi i njomjes së drurit   | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 25 tonë/vit  | Konsumi i solventëve është i barabartë me 25 tonë/vit ose më pak se kaq  |
|   |      | n. Veprimtaria e lyerjes/veshjes aplikuar në materiale lëkure  | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 10 tonë/vit  | Konsumi i solventëve është i barabartë me 10 tonë/vit ose më pak se kaq  |
|   |      | o. Prodhimi i këpucëve   | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 tonë/vit   | Konsumi i solventëve është i barabartë me 5 tonë/vit ose më pak se kaq   |
|   |      | p. Laminimi i drurit dhe plastikës   | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 tonë/vit   | Konsumi i solventëve është i barabartë me 5 tonë/vit ose më pak se kaq   |
|   |      | q. Veshja me adeziv (material ngjitës)   | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 tonë/vit   | Konsumi i solventëve është i barabartë me 5 tonë/vit ose më pak se kaq   |
|   |      | r. Prodhimi i preparateve veshëse, llaqeve, bojërave dhe ngjitësve   | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 100 tonë/vit   | Konsumi i solventëve është i barabartë me 100 tonë/vit ose më pak se kaq   |
|   |      | s. Shndërrimi i gomës  | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 15 tonë/vit  | Konsumi i solventëve është i barabartë me 15 tonë/vit ose më pak se kaq  |
|   |      | t. Ekstraktimi i vajit vegjetal dhe yndyrës së kafshëve si dhe veprimtaritë e rafinimit të vajit vegjetal                                      | ----  | Konsumimi i solventëve është më i madh se 10 tonë/vit  | Konsumi i solventëve është i barabartë me 10 tonë/vit ose më pak se kaq  |
|   |      | u. Prodhimi i produkteve farmaceutike  | ----  | Të gjitha instalimet   | -----  |
| <b>Prodhimi i produkteve plastike</b>                   | 7.13 | Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e Tipit A ose Tipit B të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike                       | ----  | -----  | Të gjitha veprimtaritë   |
| <b>Akuakulturë intensive</b>                            | 8.1  | Rritje intensive e peshqve   | ----  | Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 1000 tonë/vit ose më pak se kaq, por gjithsesi më i madh se 100 tonë peshk/vit       | Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 100 tonë peshk /vit ose më pak se kaq, gjithsesi më e madhe se 10 tonë peshk/vit |
|   | 8.2  | Rritje e guaskave të detit.  | ----- | Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 1000 tonë/vit ose më pak se kaq, por gjithsesi më i madh se 100 tonë guaska deti/vit | Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 100 tonë/vit guaska deti ose më pak se kaq, gjithsesi më i madh se 10 tonë/vit   |
| <b>Industritë prodhuese të komponentëve elektrike</b>   | 9.1  | Prodhim i kompjuterëve dhe produkteve elektronike dhe optike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.                            | ----- | Të gjitha instalimet   | -----  |
|   | 9.2  | Prodhim i pajisjeve elektrike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.   | ----- | Të gjitha instalimet   | -----  |
| <b>Industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve</b> | 10.1 | Prodhim i makinerive dhe pajisjeve n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.  | ----- | Të gjitha instalimet   | -----  |
|   | 10.2 | Prodhim i mjeteve motorike, trailerave dhe   | ----- | Të gjitha instalimet   | -----  |

|                             |      |  |   |  |  |
|-----------------------------|------|--|---|--|--|
|                             |      | gjysmëtrailerave n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.  |   |  |  |
|                             | 10.3 | Prodhim i mjeteve të tjera të transportit n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.                   | -----   | Të gjitha instalimet                               | -----  |
|                             | 10.4 | Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.          | -----   | -----  | Të gjitha instalimet   |
|                             | 10.5 | Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.              | -----   | -----  | Të gjitha instalimet   |
| <b>Prodhimi i mobiljeve</b> | 11.1 | Prodhim i mobilieeve, n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.                                       | -----   | Kapaciteti i prodhimit më i madh se 1000 m3 në vit | Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 1000 m3 në vit ose më i vogël se kaq |
| <b>Veprimtari të tjera</b>  | 12.1 | Kremimi/djegia e trupave të të vdekurve ose mbetje anatomike nga spitalet.   | -----   | Të gjitha instalimet                               | -----  |
|                             | 12.2 | Spitalet.....  |   | Të gjitha instalimet                               |  |
|                             | 12.3 | Ambulancat, spitalet ditore pa shtretër, poliklinikat dentare me mbi 3 poltrona, laboratorët mjekësorë dhe dentarë |   |  | Të gjitha instalimet   |
|                             | 12.7 | Depot farmaceutike   |   |  | Të gjitha instalimet   |
|                             | 12.4 | Kapja e rrymave të CO2   | Nga të gjitha instalimet e kategorisë A që synojnë depozitimin gjeologjik |  |  |
|                             | 12.5 | Aktivitete që emetojnë zhurma në mjedis n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë                      | -----   | -----  | Të gjitha aktivitetet  |
|                             | 12.6 | Larje dhe pastrim mjetesh motorike   | -----   | -----  | Të gjitha instalimet   |

#### SHËNIME PËR TABELËN E VEPRIMTARIVE TË TIPIT A

1. Për kategorinë 4 Industria Kimike, “prodhim” do të thotë prodhim në shkallë industriale me anë të përpunimit kimik të substancave ose grupeve të substancave të listuara në kategoritë nga 4.1 deri 4.6

2. Kimikatet organike bazë përfshijnë, por nuk mjaftohen në:

a) hidrokarburet e thjeshta (linear apo ciklik, të ngopura ose të pangopura, alifatik ose aromatik);

b) hidrokarburet që përmbajnë oksigjen, si alkoolët, aldehidët, ketonet, acidet karboksilike, esteret, acetatet, eteret, peroksidet, rezinat epokside;

c) hidrokarburet me bazë squfuri;

ç) hidrokarburet e hidrogjenuara, si aminat, amidet, përbërjet nitroze, përbërjet nitrore, ose përbërjet nitrile, përbërjet nitrile, cianatet, izocianatet;

d) hidrokarburet me përmbajtje fosfori;

dh) hidrokarburet halogjenike;

e) përbërjet organometalike;

ë) materialet me bazë plastike (polimeret, fibrat sintetike dhe fibrat me bazë celuloze);

f) gomat sintetike;

g) bojërat dhe pigmentet;

gj) lëndët tensioaktive.

3. Kimikatet inorganike bazë përfshijnë, por nuk mjaftohen në:

a) gaze, si amonium, klori ose gazi klorhidrik, floruret ose hidrogjen i floruar, oksidet e karbonit, përbërjet e squfurit, oksidet e azotit, hidrogjeni, dioksid squfuri, kloruri i karbonilit;

b) acidet, si acidi kromik, acidi hidroflorik, acidi fosforik, acidi nitrik, acidi hidroklorik, acidi sulfurik, oleumi, acide sulfurore;

c) baza, si hidroksid amoni, hidroksid potasi, hidroksid natriumi;

ç) kripërat, si klorur amoni, klorat potasi, karbonat potasi, karbonat natriumi, perborate, nitrat argjendi;

d) jo metale, oksidet e metaleve ose përbërje organike të tjera si karbit, silikon, karburi i silicit.

4. Rikuperimi i mbetjeve të rrezikshme nënkupton veprimtaritë rikuperuse të mëposhtme, siç përcaktohet në legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve:

R1. Përdorim kryesisht si karburant ose mjet të ndonjë lloji tjetër për gjenerim energjie.

R5. Riciklimi ose marrja e materialeve inorganike, përfshirë gazifikimin dhe pirolizen për t'i përdorur si kimikate.

R6. Rigjenerim i acideve ose bazave.

R8. Rikuperim i komponentëve nga katalizatorët.

R9. Rirafinimi i vajit ose ripërdorime të tjera të vajit.

5. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme nënkupton veprimtaritë asgjësuese të mëposhtme, siç përcaktohen në legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve:

D8.

D9.

6. Trajtim sipërfaqësor i substancave, objekteve ose produkteve përfshin, por nuk mjaftohet në:

- a) përpunimin;
- b) stampimin/ printimin;
- c) lyerjen/ veshjen;
- ç) zhvajosjen;
- d) mbrojtjen nga uji;
- dh) kalibrimin/përpunimin me saktësi sipas përmasave;
- e) bojatisjen/ngjyrosjen;
- ë) pastrimin;
- f) regjien/ngopjen/njomjen në thellësi.

#### SHËNIME PËR TABELËN E VEPRIMTARIVE TË TIPIT C:

Për kategorinë e listuar në pikën 12.3 të tabelës së mësipërme, zbatohen kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje mjedisi të Tipit C të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis, sipas udhëzimit të Ministrit të Mjedisit, bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis".

### LIGJ Nr. 61/2014

#### **PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.6.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8623, datë 9.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

#### **MARRËVESHJE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN**

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe,

*me dëshirën* për të nxitur marrëdhëniet e tyre ekonomike të përbashkëta nëpërmjet lidhjes së një marrëveshjeje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

#### **Personat e përfshirë**

Kjo Marrëveshje zbatohet për personat që janë rezidentë të një ose të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2

#### **Tatimet e përfshira**

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin në emër të një Shteti Kontraktues ose të një prej nënndarjeve të tij politike apo autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra sesi ato mblidhen.

2. Konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat e plota, kapitalin e plotë ose elemente të të ardhurave dhe kapitalit, duke përfshirë tatimet mbi fitimin nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat e plota të pagave ose shpërblimeve të paguara nga ndërmarrjet (si dhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit).

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje, janë veçanërisht:

a) Në rastin e Shqipërisë:

i) Tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimi i të ardhurave personale dhe tatimi i të ardhurave nga kapitali ose nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.

ii) Tatimi i aktiviteteve të biznesit të vogël; dhe

iii) Taksimi mbi pasurinë

(më poshtë i quajtur "tatimi shqiptar").

b) Në rastin e EBA-së:

i) tatimi mbi të ardhurat;

ii) tatimi mbi fitimet e shoqërive;

(më poshtë quhet "tatimi i EBA-së").

4. Kjo Marrëveshje zbatohet edhe për çdo tatim të njëjtë ose thelbësisht të ngjashëm që vendoset sipas ligjeve të Shteteve Kontraktuese pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të konsiderueshëm që është bërë në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

### Neni 3

#### Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) Termat "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" janë Emiratet e Bashkuara Arabe ose Republika e Shqipërisë, siç e kërkon konteksti;

b) Termi "Emiratet e Bashkuara Arabe", nëse përdoret në kuptimin gjeografik, është territori i Emirateve të Bashkuara Arabe, nën sovranitetin e tyre, si dhe zona jashtë ujërave territoriale, hapësira ajrore dhe zona nënujore në të cilat Emiratet e Bashkuara Arabe ushtrojnë të drejtat sovrane dhe juridiksionale në lidhje me çdo aktivitet që ushtrohet në ujin, shtratin detar, nëntokën e tij, në lidhje me shfrytëzimin ose për të shfrytëzuar burimet natyrore në pajtim me ligjin e tyre dhe të drejtën ndërkombëtare;

c) Termi "Republika e Shqipërisë" është Republika e Shqipërisë dhe, nëse përdoret në kuptimin gjeografik, është territori i Republikës së Shqipërisë duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi të, si dhe çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë që, në bazë të ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është në zonën brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin detar dhe nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

d) Termi "person" përfshin një individ, një ortakëri, një shoqëri dhe çdo organizim tjetër personash;

e) Termi "shtetas" është:

i) çdo individ që ka shtetësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë apo subjekt tjetër që e merr statusin e tij nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues ose në një nënndarje politike apo njësi të pushtetit të tyre lokal;

f) Termi "shoqëri" është një person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllimet tatimore.

g) Skemë pensioni, që është çdo plan, skemë, fond, garanci apo masë tjetër e vendosur në një Shtet

Kontraktues, përgjithësisht përjashtohet nga tatimi në atë Shtet dhe operohet kryesisht për të administruar ose dhënë përfitimin e pensionit ose për të përfutur të ardhura në përfitim të një ose disa masave të tilla;

h) Termat "ndërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" është përkatësisht një ndërmarrje e realizuar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje e realizuar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

i) Termi "trafik ndërkombëtar" është çdo transport me anije ose avion që kryhet nga një ndërmarrje që ka selinë e menaxhimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija ose avioni operon vetëm ndërmjet vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues;

j) Termi "biznes" përfshin kryerjen e shërbimeve profesionale dhe aktiviteteve të tjera të një karakteri të pavarur.

k) Termi "Njësi e kualifikuar qeveritare" është banka qendrore e një Shteti Kontraktues dhe çdo person, agjenci, institucion, autoritet, fond, ndërmarrje, organizatë ose subjekt tjetër në pronësi ose kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një Shteti Kontraktues ose të një nënndarjeje politike apo organi të pushtetit të tij lokal.

l) Termi "autoritet kompetent" është:

i) në rastin e EBA-së, Ministri i Financave ose një përfaqësues i autorizuar i Ministrisë të Financave;

ii) në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Financave ose një përfaqësues i autorizuar i Ministrisë të Financave.

2. Në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përkufizuar në të, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ai ka në atë kohë sipas ligjit të atij Shteti Kontraktues për qëllimet e tatimeve për të cilat zbatohet Marrëveshja, ku çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij Shteti mbizotëron mbi kuptimin e dhënë atij termi sipas ligjeve të tjera të atij Shteti.

### Neni 4

#### Rezidenti

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi "rezident i një Shteti Kontraktues" është:

2. a) në rastin e Republikës së Shqipërisë:

a) çdo person i cili, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet tatimit atje për shkak të vendbanimit, vendit të menaxhimit ose një kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe përfshin edhe atë Shtet ose çdo nënndarje politike ose autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që u nënshtrohet tatimeve në atë Shtet në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë Shtet ose kapitali që ndodhet në të.

b) në rastin e EBA-së:

i) një individ, i cili sipas ligjeve të EBA-së ose të një nënndarjeje politike ose një organi të pushtetit të tij lokal është shtetas;

ii) një subjekt i ndryshëm nga një individ që është themeluar ose njohur ndryshe sipas ligjeve të EBA-së ose të një nënndarjeje politike apo të një organi të pushtetit të tij lokal.

3. Për qëllimet e paragrafit 1, një rezident i një Shteti Kontraktues përfshin:

a) Qeverinë e atij Shteti Kontraktues dhe çdo nënndarje politike apo organi të pushtetit lokal apo autoritet lokal të tij;

b) çdo subjekt të ndryshëm nga një individ në pronësi apo kontroll të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të atij Shteti ose të një nënndarjeje politike apo organi të pushtetit lokal apo autoriteti lokal të tij;

c) një subjekt i kualifikuar qeveritar;

d) një fond pensionesh;

e) organizatat bamirëse apo fetare, arsimore dhe kulturore.

4. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dy Shtetet Kontraktuese, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit Kontraktues në të cilin ka një banesë të përhershme në dispozicion; nëse ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja Shtetet Kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit Kontraktues me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetikë);

b) nëse Shteti Kontraktues në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetikë nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë Shtet Kontraktues, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit Kontraktues në të cilin ka një vendbanim të zakonshëm;

c) nëse ka vendqëndrim të zakonshëm në të dyja Shtetet Kontraktuese ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit Kontraktues shtetas i të cilit ai është;

d) nëse ai është shtetas i të dy Shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

e) Nëse statusi i tij nuk mund të përcaktohet sipas dispozitave të nënparagrafit “c”, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

5. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja Shteteve Kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit Kontraktues ku është themeluar.

## Neni 5

### Njësia e përhershme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “njësi e përhershme” është një vend i caktuar biznesi nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “njësi e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte;

f) një minierë, një pus gazi ose naftë apo një gurorë ose një vend tjetër të eksplorimit, nxjerrjes ose shfrytëzimit të burimeve natyrore ose një aktiviteti tjetër në lidhje me të, duke përfshirë një platformë shpimi në det të hapur.

3. Një kantier ndërtimi, ndërtim, një impiant apo projekt instalimi apo aktivitetet mbikëqyrëse në lidhje me to ose një platformë shpimi apo anije e përdorur për eksplorimin ose shfrytëzimin e burimeve natyrore përbën një njësi të përhershme vetëm nëse ky kantier, projekt apo aktivitet vazhdon për një periudhë më të gjatë se 6 muaj.

4. Dhënia e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës dhe menaxheriale, nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim në Shtetin tjetër Kontraktues, përbën një njësi të përhershme vetëm nëse aktivitetet e asaj natyre vazhdojnë për një periudhë ose disa periudha që nëse mbledhen janë më shumë se 9 muaj.

5. Një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues konsiderohet të ketë një njësi të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues nëse përdoren pajisje ose makineri të konsiderueshme mekanike ose shkencore për më shumë se tetëmbëdhjetë muaj ose instalohen në atë Shtet tjetër Kontraktues për ose sipas kontratës me ndërmarrjen.

6. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “njësi e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi, ose dorëzimin e mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose dorëzimi;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të kryerjes nga ana e ndërmarrjes të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

7. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person - i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 9 - vepron në emër të një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ajo ndërmarrje konsiderohet të ketë një njësi të përhershme në Shtetin e parë Kontraktues në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, nëse ai person:

a) ka dhe ushtron zakonisht në Shtetin e parë Kontraktues një autoritet për të lidhur kontrata në emër të kësaj ndërmarrjeje, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen tek ato të përmendura në paragrafin 6 që, nëse ushtrohet nëpërmjet një vendi të caktuar të biznesit, nuk do ta bënte këtë vend të caktuar biznesi njësi të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi;

b) nuk ka autoritet të tillë, por zakonisht mban në Shtetin e parë Kontraktues një sasi mallrash gjendje që i përkasin kësaj ndërmarrjeje, nga të cilat ai dorëzon rregullisht mallra në emër të ndërmarrjes.

c) siguron vazhdimisht porosi në Shtetin e parë Kontraktues, ekskluzivisht ose pothuaj ekskluzivisht për vetë ndërmarrjen ose për atë ndërmarrje dhe ato ndërmarrje, të cilat kontrollohen prej saj ose kanë interes kontrollues në të.

d) duke vepruar kështu, ai prodhon ose përpunon në atë Shtet Kontraktues për ndërmarrjen mallra që i përkasin ndërmarrjes.

8. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, një ndërmarrje sigurimi e një Shteti Kontraktues, përveçse në lidhje me risigurimin, konsiderohet të ketë një njësi të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues nëse ajo mbledh prime në territorin e atij Shteti tjetër ose siguron risqet që gjenden atje nëpërmjet një personi, të ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 8.

9. Një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues nuk konsiderohet të ketë njësi të përhershme në një Shtetin tjetër Kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë Shtet tjetër Kontraktues nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë në ushtrim të zakonshëm të biznesit të tyre. Megjithatë, nëse aktivitetet e këtij agjenti përkushtohen tërësisht ose pothuaj tërësisht në emër të asaj ndërmarrjeje dhe ndërmarrjeve të tjera të cilat

kontrollohen prej saj ose kanë interes kontrollues në të, ai nuk konsiderohet të jetë agjent me status të pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi.

10. Pavarësisht dispozitës së paragrafit 9 të këtij neni, shoqëritë e sigurimeve që janë në pronësi ose kontrollohen nga një Shtet Kontraktues ose organet e tij lokale apo autoritetet lokale trajtohen ndryshe për qëllimet tatimore dhe i nënshtrohen tatimit vetëm në shtetin e regjistrimit.

11. Fakti që një shoqëri e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollohet ose kontrollohet nga një shoqëri e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues ose që zhvillon biznes në atë Shtet tjetër Kontraktues (nëpërmjet një njësie të përhershme ose ndryshe), nuk përbën në vetvete që një prej këtyre shoqërive është njësi e përhershme e tjetrës.

#### Neni 6

#### **Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme**

1. Të ardhurat që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) që gjenden në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë Shtet tjetër Kontraktues.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjeve të brendshme të Shtetit Kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin pasurinë aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me pasurinë e paluajtshme, uzufruktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si shpërblim për punën ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

#### Neni 7

#### **Fitimet nga biznesi**

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në atë Shtet tjetër Kontraktues. Nëse ndërmarrja zhvillon ose ka zhvilluar biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues, por vetëm për ato që i takojnë asaj njësie të përhershme.



2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur atje, fitimet të cilat mund të pritej të nxirrtë nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen njësi e përhershme e së cilës ajo është, në secilin Shtet Kontraktues do t'i atribuohen atij vendqëndrimi të përhershëm.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një njësie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet e zbritshme që janë bërë për qëllime të njësisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative të bëra qoftë në Shtetin Kontraktues ku ndodhet njësi e përhershme ose në një vend tjetër.

4. Asnjë fitim nuk i atribuohet një njësie të përhershme vetëm për shkak të blerjes nga ajo njësi e përhershme të mallrave për ndërmarrjen.

5. Për sa kohë që në një Shtet Kontraktues zbatohet përcaktimi i fitimeve që i atribuohen një njësie të përhershme mbi bazën e një ndarjeje të fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesë të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk përjashton atë Shtet Kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të taton nga kjo ndarje, siç mund të jetë e zakonshme; megjithatë, metoda e zbatuar për ndarjet do të jetë e tillë që rezultati të jetë në pajtim me parimet në përmbajtje të këtij neni.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që i atribuohen njësisë së përhershme përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave ose fitimet që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

#### Neni 8

##### **Transporti me anije dhe avion**

Pavarësisht dispozitave të nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje:

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues nga operimi i anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar, taton vetëm në atë Shtet Kontraktues.

2. Për qëllimet e këtij neni, fitimet nga operimi i anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar përfshijnë:

a) fitimet nga qiradhënia pa pajisje e anijeve ose avionëve;

b) fitimet nga përdorimi, mirëmbajtja ose dhënia me qira e kontejnerëve, duke përfshirë trailerat/rimorkiot dhe pajisjet përkatëse për transportin e kontejnerëve, që përdoren për transportin e mallrave;

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen gjithashtu për fitimet e përfutuara nga:

a) pjesëmarrja në një grup ekonomik, biznes të përbashkët ose një agjenci operative ndërkombëtare;

b) shitja e biletave në emër të një ndërmarrjeje tjetër;

c) të ardhurat nga skemat e trajnimit;

d) të ardhurat nga shitja e inxhinierisë teknike një pale të tretë;

e) të ardhurat që rrjedhin nga depozitat në bankë, obligacione, aksione ose letra të tjera me vlerë.

#### Neni 9

##### **Ndërmarrjet e asociuara**

1. Kur:

a) Një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

b) Të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që në mungesë të atyre kushteve, do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve, por për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe si rrjedhojë të taton.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti Kontraktues - dhe si rrjedhojë taton - fitimet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është tatar në atë Shtet tjetër Kontraktues dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së Shtetit Kontraktues të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë Shteti tjetër Kontraktues do të bëjë një rregullim të përshtatshëm ndaj shumës së fitimeve që i nënshtrohet tatimit. Në përcaktimin e këtij rregullimi duhet t'u kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, sipas rastit, konsultohen me njëri-tjetrin.

#### Neni 10

##### **Dividendët**

1. Dividendët e paguar nga një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, i cili është pronari përfitues i këtyre dividendëve, mund të taton në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të taton gjithashtu në Shtetin Kontraktues në të cilin është

rezidente shoqëria që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon:

a) 0 % të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është Shteti tjetër Kontraktues ose një institucion qeveritar apo një subjekt që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues sipas dispozitave të nënparagrafëve “a”, “b” të paragrafit 2 të nenit 4;

b) 5% të shumës bruto të dividendëve nëse pronari përfitues është një shoqëri (e ndryshme nga një ortakëri), e cila zotëron të paktën drejtpërdrejt 10% të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët;

c) 10 % të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

3. Termi “dividendë”, siç përdoret në këtë nen, janë të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejtat e tjera që nuk janë pretendime borxhi, të cilat marrin pjesë në fitime, si dhe të ardhura nga të drejta të tjera të shoqërive që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit në të cilin shoqëria që kryen shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznesin në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhet dividendët është efektivisht e lidhur me këtë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 6 ose të nenit 13.

#### Neni 11

##### Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një Shtet Kontraktues dhe i paguar një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues tatohet në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Termi “interes”, siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i garantuar apo jo me hipotekë, pavarësisht nëse ka të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë primet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve dhe dëftesave të borxhit, si dhe të ardhura të cilat i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga shumat financiare të dhëna hua sipas ligjeve tatimore të Shtetit Kontraktues ku lindin të ardhurat.

3. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin nxirret interesi, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në Shtetin tjetër

Kontraktues ose kryen në Shtetin tjetër Kontraktues shërbime të pavarura personale nga një bazë fikse që gjendet në Shtetin tjetër Kontraktues dhe pretendimi i borxhit në lidhje me të cilin paguhet interesi është efektivisht e lidhur me këtë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 6 ose nenit 13.

4. Interesi konsiderohet të lindë në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti Kontraktues. Megjithatë, nëse personi që paguan interesin, qoftë rezident i Shtetit Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues një njësi të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga kjo njësi e përhershme ose bazë fikse, atëherë interesi do të lindë në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet njësia e përhershme ose baza fikse.

5. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues të interesit ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke patur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 12

##### Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave të nxjerra në një Shtet Kontraktues dhe të paguara një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Megjithatë, këto tarifa licencash mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues në të cilin nxirren dhe sipas ligjeve të atij Shteti Kontraktues, por nëse pronari përfitues i tarifave të licencave është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 5% të shumës bruto të tarifave të licencave. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, me marrëveshje të ndërsjella, zgjidhin mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi "tarifa të licencave", që përdoret në këtë nen, janë pagesat e çdo lloji që përftohen si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori në veprën letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filmat kinematografikë dhe punët për filmat, shiritat dhe mjete të tjera të riprodhimit për përdorim në lidhje me transmetimin televiziv dhe radiofonik, çdo patente, marke tregtare, dizajno ose model, plan, formulë sekrete ose procesi ose për informacionin (ekspertizën) në lidhje me përvojën industriale, tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i tarifave të licencave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin nxirren tarifat e licencave, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues ose kryen në Shtetin tjetër Kontraktues shërbime të pavarura personale nga një bazë fikse që gjendet në Shtetin tjetër Kontraktues dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilën paguhet tarifa e licencave është efektivisht e lidhur me këtë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 6 ose nenit 13.

5. Tarifat e licencave do të lindin në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti Kontraktues. Megjithatë, nëse personi që paguan tarifat e licencave, qoftë rezident i Shtetit Kontraktues apo jo, ka në një Shtet Kontraktues një njësi të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur detyrimi për të paguar tarifat e licencave dhe këto tarifa licencash përballohen nga kjo njësi e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto tarifa licencash do të lindin në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet njësia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues të tarifave të licencave ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e tarifave të licencave, duke patur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin paguhen, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit Shtet Kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 13

##### **Fitimet e kapitalit**

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 4 dhe që ndodhin në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbëjnë pjesë të pronës së biznesit të një njësie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose të pasurisë së luajtshme që i përket një baze fikse të disponueshme nga një rezident i një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllimin e kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj njësie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose të kësaj baze fikse, taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues.

3. Fitimet e nxjerra nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose fitimet e pasurive të luajtshme që i përkasin operacioneve të këtyre anijeve ose avionëve, taten vetëm në atë Shtet Kontraktues.

4. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve duke nxjerrë më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një pasuri e paluajtshme që gjendet në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në Shtetin tjetër.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo sendi pasuror, të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, janë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

#### Neni 14

##### **Shërbime personale të pavarura**

1. Të ardhurat e përftuara nga një individ, i cili është rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose aktivitetet e tjera të një karakteri të pavarur, janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues, përveçse në një prej rrethanave të mëposhtme, kur këto të ardhura mund të taten edhe në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) Nëse ai ka një bazë fikse rregullisht të disponueshme prej tij në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të tij; në këtë rast vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i përket asaj baze fikse mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues;

b) Nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që janë të barabarta ose kalojnë të tërësi 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmuajore që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që përfitohet në Shtetin tjetër Kontraktues gjatë periudhës ose periudhave të sipërpërmendura mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose mësimdhënëse, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, juristëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe kontabilistëve.

#### Neni 15

##### **Shërbime personale të varura**

1. Në bazë të dispozitave të nenit 16, 18, 19, 20 dhe 21, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues, nëse punësimi nuk ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që përfitohet atje mund të taten në atë Shtet tjetër Kontraktues.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, shpërblimi i nxjerrë nga një rezident i një Shteti Kontraktues tatóhet vetëm në Shtetin Kontraktues të përmendur fillimisht, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Përfituesi është i pranishëm në Shtetin tjetër Kontraktues për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore, e cila fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës;

b) Shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues.

c) Shpërblimi nuk përballohet nga një vendqëndrim i përhershëm ose një bazë fikse, të cilën punëdhënësi ka në Shtetin tjetër Kontraktues.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përfutur nga një punësim i ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni që operon në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues, tatóhet vetëm në atë Shtet Kontraktues.

4. Një individ, i cili është shtetas i një Shteti Kontraktues dhe i punësuar i një ndërmarrjeje të atij Shteti Kontraktues, biznesi kryesor i të cilit përbëhet nga operimi i avionëve në trafikun ndërkombëtar dhe që e merr shpërblimin në lidhje me detyrat e kryera në Shtetin tjetër Kontraktues, tatóhet vetëm në atë Shtet Kontraktues për shpërblimin e marrë nga punësimi i tij në atë ndërmarrje.

#### Neni 16

##### **Tarifat e drejtuesve**

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve ose një organi të ngjashëm të një shoqërie e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, tatóhen në Shtetin e parë Kontraktues.

#### Neni 17

##### **Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat që përftohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues si argëtues, artist teatri, filmi, radioje ose televizioni, muzikant apo sportist, nga aktivitetet personale të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatóhen në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një argëtues ose sportist në cilësinë e tij si i tillë, nuk përftohen nga subjekti argëtues ose sportisti por nga një person tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatóhen në Shtetin Kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen për të ardhurat që nxirren nga argëtuesit ose sportistët të cilët janë rezidentë të një Shteti Kontraktues nga aktivitetet personale që ushtrohen si të tilla në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse vizita e tyre në Shtetin tjetër kontraktues mbështetet kryesisht nga fondet publike të Shtetit të parë Kontraktues, duke përfshirë ato të një nënndarjeje politike, autoriteti lokal ose organ statutor të tij, dhe as për të ardhurat e nxjerra nga një organizatë jofitimprurëse në lidhje me këto aktivitete, me kusht që asnjë pjesë e të ardhurave të saj të mos i paguhet apo të mos jetë ndryshe e disponueshme për përfitim personal të pronarëve, themeluesve apo anëtarëve të saj.

#### Neni 18

##### **Pensionet**

Në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet, shpërblimet e ngjashme dhe rentat jetësore të paguara një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me punësimin e kaluar, tatóhen vetëm në atë Shtet Kontraktues.

#### Neni 19

##### **Shërbimi qeveritar**

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga një pension, të paguara nga një Shtet Kontraktues ose një nënndarje politike ose autoritet lokal i tij një individ në lidhje me shërbimet e kryera për atë Shtet Kontraktues ose nënndarje ose autoritet, janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues.

b) Megjithatë, këto rroga, paga ose shpërblime të tjera të ngjashme janë të tatueshme vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë Shtet Kontraktues dhe nëse individ është rezident i atij Shteti Kontraktues dhe ka përmbushur një nga kushtet e mëposhtme:

i) është shtetas i atij Shteti Kontraktues;

ii) nuk është bërë rezident i atij Shteti Kontraktues vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga ose nga fondet e krijuara nga një Shtet Kontraktues, ose një nënndarje politike apo autoritet lokal i tij një individ në lidhje me shërbimet e kryera për atë Shtet Kontraktues ose nënndarje ose autoritet, janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues.

b) Megjithatë, ky pension është i tatueshëm vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individ është rezident dhe shtetas i atij Shteti Kontraktues.

3. Dispozitat e neneve 15,16, 17 dhe 18 zbatohen për rrogat, pagat, dhe shpërblime të tjera të ngjashme dhe pensionet në lidhje me shërbimet e kryera për një biznes të zhvilluar nga një Shtet Kontraktues ose nënndarje e tij politike ose autoritet lokal i tij.

Neni 20

**Mësuesit dhe kërkuesit**

Një individ i cili është ose ishte menjëherë para se të vizitonte një Shteti Kontraktues, rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që me ftesë të qeverisë së Shtetit të parë Kontraktues ose të një kolegjii universiteti, shkolle, muzeumi ose institucioni tjetër kulturor në Shtetin e parë Kontraktues ose sipas një programi zyrtar të shkëmbimit kulturor, është i pranishëm në atë Shtet Kontraktues për një periudhë që nuk kalon dy vjet të njëpasnjëshëm vetëm për qëllimin e mësimdhënies, dhënies së leksioneve apo kryerjes së kërkimeve në këtë institucion, përjashtohet nga tatimi në atë Shtet Kontraktues për shpërblimin e tij për këtë aktivitet.

Neni 21

**Studentët dhe praktikantët**

1. Pagesat që merr një student ose praktikant biznesi, i cili është ose ishte menjëherë para vizitës në Shtetin Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është i pranishëm në Shtetin e parë Kontraktues vetëm për qëllimin e arsimimit dhe trajnimit të tij, për qëllimin e jetesës, arsimimit ose trajnimit nuk taten në atë Shtet Kontraktues, me kusht që këto pagesa rrjedhin nga burime jashtë atij Shteti Kontraktues.

2. Në lidhje me grantet, bursat dhe shpërblimin nga punësimi që nuk mbulohen nga paragrafi 1, një student ose praktikant biznesi i përshkruar në paragrafin 1 gjithashtu ka të drejtën gjatë arsimimit ose trajnimit për të njëjtat përjashtime, uljeje dhe zbritje në lidhje me tatimet që vendosen për rezidentët e Shtetit Kontraktues që ai viziton.

Neni 22

**Të ardhura të tjera**

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues kudo që lindin, të patrajuara në nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje, janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfutuesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të ose kryen në Shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat, është efektivisht e lidhur me atë njësi të përhershme. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 7.

Neni 23

**Të ardhurat nga hidrokarburet**

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Konvente, asgjë nuk cenon të drejtën e secilit prej shteteve të tyre

lokale në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të tyre të brendshme në lidhje me tatimin e të ardhurave dhe fitimeve që nxirren nga hidrokarburet dhe aktivitetet e lidhura me to që gjenden në territorin e Shtetit Kontraktues përkatës, sipas rastit.

Neni 24

**Tatimi i kapitalit**

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e paluajtshme e përmendur në nenin 6, në pronësi të një rezidenti të një Shteti Kontraktues dhe që gjendet në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taton në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e luajtshme që përbën pjesë të pronës së biznesit të një njësie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, ose nga pasuria e luajtshme që i përket një baze fikse të disponueshme nga një rezident i një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues, për qëllimin e kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, mund të taton në atë Shtet tjetër Kontraktues.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet dhe avionët që operojnë në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues dhe nga pasuria e luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve ose avionëve dhe barkave, janë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin gjendet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë Shtet Kontraktues.

Neni 25

**Eliminimi i tatimit të dyfishtë**

Tatimi i dyfishtë eliminohet në Shtetet Kontraktuese si më poshtë:

I. Në rastin e Shqipërisë:

1. Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura ose ka në pronësi kapital, i cili në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të taton në Emiratet e Bashkuara Arabe, Shqipëria lejon:

a) si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Emiratet e Bashkuara Arabe;

b) si zbritje nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Megjithatë, kjo zbritje në asnjë rast nuk kalon pjesën e tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin që llogaritet para kryerjes së zbritjes që u takon, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të taton në Emiratet e Bashkuara Arabe.

2. Nëse në pajtim me një dispozitë të Konventës, të ardhurat e përfuara ose kapitali në pronësi të një rezidenti

të Shqipërisë janë të përjashtuara nga tatimi në Shqipëri, Shqipëria, në llogaritjen e shumës së tatimeve mbi të ardhurat e mbetura ose kapitalit të këtij rezidenti, mund të marrë përsëri parasysh të ardhurat e përjashtuara ose kapitalin.

3. Për qëllimin e paragrafit 1 dhe 2, fitimet, të ardhurat dhe përfitimet në pronësi të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, të cilat mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues në pajtim me këtë Marrëveshje, do të rrjedhin nga burime në atë Shtet tjetër.

#### II. Në rastin e Emirateve të Bashkuara Arabe:

1. Nëse një rezident i Emirateve të Bashkuara Arabe përfton të ardhura ose ka në pronësi kapital, i cili në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të taten në Shqipëri, Emiratet e Bashkuara Arabe lejojnë:

a) si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat të atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Shqipëri;

b) si zbritje nga tatimi mbi kapitalin e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Shqipëri;

Megjithatë, kjo zbritje në asnjë rast nuk kalon pjesën e tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin që llogaritet para kryerjes së zbritjes, i cili u takon, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të taten në Shqipëri.

2. Nëse në pajtim me një dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat e përftuara ose kapitali në pronësi të një rezidenti të Emirateve të Bashkuara Arabe janë të përjashtuara nga tatimi në Emiratet e Bashkuara Arabe, Emiratet e Bashkuara Arabe, në llogaritjen e shumës së tatimeve mbi të ardhurat e mbetura ose kapitalit të këtij rezidenti, mund të marrin përsëri parasysh të ardhurat e përjashtuara ose kapitalin.

3. Për qëllimin e paragrafit 1 dhe 2, fitimet, të ardhurat dhe përfitimet në pronësi të një rezidenti të një Shteti Kontraktues të cilat mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues në pajtim me këtë Marrëveshje, do të rrjedhin nga burime në Shtetin tjetër.

#### Neni 26

##### Procedura e Marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person konsideron se veprimet e një ose dy Shteteve Kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre Shteteve Kontraktuese, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues në të cilin është rezident ose nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 28 të Shtetit Kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatimin në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoriteti kompetent, nëse kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiqet të zgjidhë çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që nuk është në pajtim me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht nga afatet kohore në ligjin e brendshëm të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ata gjithashtu, mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet që nuk janë parashikuar në këtë Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri - tjetrin për qëllimin e arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

#### Neni 27

##### Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese shkëmbejnë atë informacion që çmohet i nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për administrimin apo zbatimin e ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese në lidhje me tatimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje të vendosura në emër të Shteteve Kontraktuese ose të nënndarjeve të tyre politike apo autoriteteve lokale, në masën që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një Shtet Kontraktues trajtohet si sekret në të njëjtën mënyrë si informacioni i përftuar sipas ligjeve të brendshme të atij Shteti Kontraktues dhe u deklarohe vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me ose përcaktimin e ankimeve në lidhje me tatimet e mbuluara nga kjo Marrëveshje. Këta persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në seanca gjyqësore me detyrë të hapura ose në vendime gjyqësore.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk interpretohen sikur vendosin mbi një Shtet Kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën administrative të tij ose të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacion që nuk është i përftueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administratës në të ose në Shtetin tjetër Kontraktues;

c) të japë informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial ose profesional ose proces

tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një Shtet Kontraktues në pajtim me këtë nen, Shteti tjetër Kontraktues përdor masat e tij për mbledhjen e informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, megjithëse atij Shteti tjetër mund të mos i duhet ky informacion për qëllimet e tij tatimore. Detyrimi i parashikuar në fjalinë e mësipërme i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen sikur lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit vetëm për faktin se nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

5. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 3 nuk interpretohen sikur lejojnë një Shtet Kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit vetëm pasi informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i emëruar ose një person që vepron në një agjenci ose në mirëbesim, ose për faktin se ka lidhje me interesa pronësie të një personi.

#### Neni 28 **Mosdiskriminimi**

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk i nënshtrohen tatimit apo ndonjë kërkesë në lidhje me të në Shtetin tjetër Kontraktues që është e ndryshme ose më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat përkatëse të cilave u nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen shtetasit e atij Shteti tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht dispozitave të nenit 1, zbatohet edhe për personat të cilët nuk janë rezidentë të një ose dy Shteteve Kontraktuese.

2. Tatimi mbi një njësi të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë Shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij Shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë nuk interpretohet sikur detyron një Shtet Kontraktues për t'iu dhënë rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues shtesa, ulje apo zbritje personale për qëllime tatimore në emër të statusit civil apo përgjegjësive familjare që ai u jep rezidentëve të vet.

3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 5 të nenit 11 ose paragrafit 4 të nenit 12, interesi, tarifat e licencave dhe disbursime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim përcaktimin e fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjta kushteve sikur t'i ishin paguar një rezidenti të Shtetit të përmendur më parë. Gjithashtu, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për qëllimin e përcaktimit

të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, është i zbritshëm sipas të njëjta kushteve, sikur ato t'i ishin kontraktuar një rezidenti të Shtetit të parë.

4. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose zotërohet tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk i nënshtrohet asnjë tatimi ose kërkesë në lidhje me të në Shtetin e përmendur më parë, që është e ndryshme ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat përkatëse të të cilave mund t'i nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit të përmendur më parë.

5. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk pengon një Shtet Kontraktues nga dhënia e një përjashtimi nga tatimet ose zbritja për shoqëritë e veta të brendshme në pajtim me ligjet dhe rregulloret e veta kombëtare.

6. Në këtë nen, termi "tatim" janë tatimet të cilat i nënshtrohen kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 29 **Rregulla të ndryshme**

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk interpretohen për të kufizuar në ndonjë mënyrë asnjë përjashtim, zbritje, kredi ose përfitim tashmë ose më vonë të dhënë:

a) nga ligjet e një Shteti Kontraktues në përcaktimin e tatimeve të vendosura nga ai Shtet Kontraktues;

b) nga një masë tjetër e veçantë mbi tatimin ndërmjet Shteteve Kontraktuese ose ndërmjet një prej Shteteve Kontraktuese dhe rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues.

#### Neni 30 **Të ardhurat e qeverisë dhe institucioneve**

Në lidhje me paragrafin 3 të nenit 6 dhe paragrafin 4 të nenit 13, të ardhurat e përftuara nga Shteti ose organet e pushtetit lokal, autoritetet lokale ose nënndarjet politike, organet statutore, agjencitë dhe strukturat dhe institucionet financiare të tyre, janë të tatueshme vetëm në Shtetin e rezidencës.

#### Neni 31 **Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore**

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk cenon privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose zyrave konsullore ose të punësuarve të organizatave ndërkombëtare sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

#### Neni 32 **Hyrja në fuqi**

Secili prej Shteteve Kontraktuese njofton tjetrin me shkrim për përfundimin e procedurave të tij kushtetuese

për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit dhe dispozitat e saj pas kësaj kanë fuqi në të dy Shtetet Kontraktuese:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, për shumat e paguara ose kredituara, në ose pas ditës së parë të janarit të vitit në të cilin është nënshkruar Marrëveshja;

b) në lidhje me tatimet e tjera, për periudhat e tatueshme që fillojnë në ose pas ditës së parë të janarit të vitit në të cilin është nënshkruar Marrëveshja.

Neni 33

### **Kohëzgjatja dhe zgjidhja**

Marrëveshja mbetet në fuqi deri sa të prishet nga një prej Shteteve Kontraktuese. Çdo Shtet Kontraktues mund ta prishë Marrëveshjen duke bërë njoftim me shkrim gjashtë muaj para zgjidhjes, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën gjashtë muaj para përfundimit të vitit kalendarik që fillon pas mbarimit të një periudhe prej pesë vjetësh nga data e hyrjes së saj në fuqi. Në këtë rast Marrëveshja pushon së qeni në fuqi në lidhje me të ardhurat e nxjerra ose kapitalin në pronësi në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik, pas atij në të cilin është bërë njoftimi i zgjidhjes.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht për këtë nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, ditën e enjte, më 13 mars 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, arabe e dhe angleze, ku në rast mospërputhjeje në interpretim ndërmjet teksteve në shqip dhe arabisht, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

**MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME**

**Ditmir Bushati**

Për Qeverinë e Emirateve të Bashkuara Arabe

**MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME**

**Abdullah Bin Zayed Al Nahyan**

### **PROTOKOLL**

Me nënshkrimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, të poshtëshënuarit kanë rënë dakord që dispozitat e mëposhtme të përbëjnë pjesë integrale të Marrëveshjes:

i) Në lidhje me nenin 13, paragrafi 5:

Kuptohet që përfitimet nga tjetërsimi i aksioneve në një shoqëri të ndryshme nga ato aksione të një shoqërie të parashikuar në paragrafin 1, 2, 3 dhe 4 ose të letrave me vlerë, obligacioneve, letrave të borxhit dhe të tjera janë të

tatueshme në shtetin ku është rezident tjetërsuesi.

Gjithashtu, kuptohet që nëse aksionet shiten nga zotëruesi i aksioneve shoqërisë emetuese në lidhje me likuidimin e kësaj shoqërie ose zbritjen e kapitalit të paguar, diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe vlerës nominale trajtohet si shpërndarje e fitimeve të akumuluar dhe jo si fitime të kapitalit.

ii) Në lidhje me nenin 30, kuptohet që institucionet financiare, agjencitë, strukturat, veçanërisht në rastin e EBA-së, kanë kuptimin joekskluziv të mëposhtëm:

a) Subjekte të tilla si (Autoriteti i Investimeve të EBA-së, Autoriteti i Investimeve Abu Dabi, Këshilli i Investimeve Abu Dabi, Mubadala, Korporata e Investimeve të Dubait, Dubai World, Shoqëria Ndërkombëtare e Naftës Abu Dabi, Shoqëria Aksionere Dahra, TAQA, Banka Qendrore);

b) Fondet e Pensioneve;

c) Organizata Bamirëse, dhe

d) Institucione të tjera të cilat janë në pronësi pjesërisht (më shumë se 50%) ose tërësisht të shtetit ose pushtetit lokal, siç është rënë dakord me shkëmbimin e letrave ndërmjet Shteteve Kontraktues.

Në rastin e Shqipërisë:

a) Qeveria e Shqipërisë përfshin të gjitha institucionet në pronësi të Qeverisë së Shqipërisë.

b) Çdo institut, organ ose pushtet lokal siç është rënë dakord nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet Shteteve Kontraktuese.

iii) Gjithashtu, kuptohet që një rezidenti të një Shteti Kontraktues, i cili nuk është person i kualifikuar ose me të drejtë për të përfituar nga Marrëveshja, i jepen përfitimet e Marrëveshjes nëse autoriteti kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues përcakton që themelimi, përfitimi ose mbështetja e këtij personi dhe kryerja e aktivitetit të tij nuk kanë pasur si një prej qëllimeve kryesore marrjen e përfitimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht për këtë nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Tiranë, ditën e enjte, më 13 mars 2014, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku në rast mospërputhjeje në interpretim ndërmjet teksteve në shqip dhe arabisht, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

**MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME**

**Ditmir Bushati**

Për Qeverinë e Emirateve të Bashkuara Arabe

**MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME**

**Abdullah Bin Zayed Al Nahyan**



**LIGJ**  
**Nr. 62/2014**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË**  
**SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR**  
**SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË,**  
**LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT**  
**DHE MBI KAPITALIN DHE PËR**  
**PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për shmangien e tatimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.6.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8624, datë 9.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR**  
**SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË LIDHUR**  
**ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI**  
**KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E**  
**EVAZIONIT FISKAL**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm dhe lehtësimin e marrëdhënieve të tyre ekonomike, duke dëshiruar të përfundojnë këtë Marrëveshje,

kanë rënë dakord për sa vijon:

**Neni 1**

**Personat e përfshirë**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit apo të të dy Shteteve Kontraktuese.

**Neni 2**  
**Tatimet e përfshira**

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj tatimeve mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të zbatuara në emër të Shteteve Kontraktuese apo të nënndarjeve të tyre politike apo administrative, pavarësisht nga mënyra sesi ato mblidhen.

2. Do të konsiderohen si "tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin" të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin total apo mbi elemente të të ardhurave apo të kapitalit, përfshirë tatimet mbi përfitimet nga tjetërsimi i pasurisë së tundshme apo të patundshme, tatimet mbi shumat totale të rrogave apo pagave të paguara nga ndërmarrjet, si edhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese, ndaj të cilave do të zbatohet Marrëveshja janë në veçanti:

a) Në Republikën e Shqipërisë:

i) Tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimin mbi të ardhurat personale nga përfitimet kapitale dhe nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.

ii) Tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël; dhe

iii) Tatimi mbi pasurinë.

Në vijim do t'i referohemi si "tatimet në Shqipëri".

b) në Republikën e Kosovës:

i) Tatimi mbi të ardhurat personale;

ii) Tatimi mbi të ardhurat e korporatave;

iii) Tatimi në pronë.

Në vijim do t'i referohemi si "tatimet në Kosovë".

4. Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu ndaj çdo tatimi të njëjtë apo tatimeve esencialisht të ngjashme që janë vendosur pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, në lidhje me, apo në vend të, tatimeve ekzistuese.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) Termi "person" përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

b) Termi "shoqëri" nënkupton çdo trup korporativ apo çdo entitet ligjor që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

c) Termi "ndërmarrje" nënkupton ushtrimin e çfarëdolloj veprimtarie;

d) Termat "ndërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë respektivisht një veprimtari të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një veprimtari të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

e) Termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije apo avion të kryer nga një person që ka

vendin e tij të drejtimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveçse kur anija ose avioni vepron vetëm ndërmjet vendeve të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues;

f) Termi “autoritet kompetent” nënkupton:

i) në rastin e Shqipërisë:

Ministria e Financave apo një përfaqësues i autorizuar i Ministrit të Financave.

ii) në rastin e Kosovës:

Ministria e Financave apo një përfaqësues i autorizuar i Ministrit të Financave.

g) Termi “shtetas” në lidhje me një Shtet Kontraktues nënkupton:

i) çdo individ që zotëron shtetësinë e një Shteti Kontraktues; dhe

ii) çdo person juridik, ortakëri apo shoqatë që gëzon statusin si e tillë nga ligjet në fuqi në atë Shtet Kontraktues;

h) Termi “biznes” përfshin kryerjen e shërbimeve profesionale dhe të veprimtarive të tjera të një karakteri të pavarur.

i) Termit “Shteti kontraktues dhe Shteti tjetër kontraktues” nënkuptojnë përkatësisht Republikën e Shqipërisë ose Republikën e Kosovës siç e kërkon përmbajtja;

j) Termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me ligjet e saj, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë ushtron të drejtat e saj në lidhje me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore.

k) Termi “Kosovë” nënkupton Republikën e Kosovës, përfshirë të gjithë territorin e Kosovës, hapësirën mbi të, për të cilën ajo ushtron juridiksionin ose të drejtën sovranë për qëllime shfrytëzimi, hulumtimi dhe konservimi të burimeve natyrore në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

2. Për sa i përket zbatimit të Marrëveshjes në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë në atë kohë në legjislacionin e atij Shteti për qëllime të tatimeve ndaj të cilave zbatohet Marrëveshja, çdo kuptim i dhënë në ligjet tatimore në fuqi të atij Shteti do të ketë përparësi mbi kuptimin që i jepet termi në ligje të tjera të atij Shteti.

#### Neni 4 Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person i cili, sipas ligjeve të atij Shteti, u nënshtrohet tatimeve të atij Shteti për shkak të qëndrimit, banimit, rezidencës, vendit të menaxhimit apo të ndonjë kriteri

tjetër me natyrë të ngjashme, dhe gjithashtu përfshin atë Shtet dhe çdo nënndarje politike apo administrative në atë Shtet. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë Shtet lidhur vetëm me të ardhurat nga burime në atë Shtet apo nga kapitali i vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; nëse ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy Shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetikë);

b) nëse Shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetikë nuk mund të përcaktohet, ose nëse ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin Shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit në të cilin qëndron zakonisht;

c) nëse ai qëndron zakonisht në të dy shtetet apo në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit, shtetas i të cilit është;

d) nëse ai është shtetas i të dy shteteve apo asnjërit prej tyre, atëherë autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person, përveç individit, është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit në të cilin ndodhet vendi i tij i drejtimit efektiv.

#### Neni 5 Njësia e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “Njësi e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i ndërmarrjes.

2. Termi “Njësi e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend drejtimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte, dhe

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, apo çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore;

3. a) Një shesh ndërtimi, projekt ndërtimi ose instalimi kur zgjat më shumë se gjashtë muaj;

b) Furnizime shërbimesh, duke përfshirë shërbimet e konsulencës, nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësish apo personeli tjetër të punësuar nga ndërmarrja për qëllime të tilla përbën një njësi të përhershme, por vetëm kur aktivitetet e kësaj natyre (për të njëjtin apo

projekte të lidhura) zgjasin brenda vendit për një periudhë apo shuma periudhash për më shumë se tre muaj brenda një periudhe dymbëdhjetë muajsh.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, termi “Njësi e përhershme” nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e ambienteve vetëm për qëllime magazinimi, shpërndarjeje apo ekspozimi të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi apo shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një gjendjeje mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim përpunimi nga një ndërmarrje tjetër;

ç) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave apo për mbledhje informacioni për ndërmarrjen;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit të çdo aktiviteti me karakter përgatitor ose ndihmës për ndërmarrjen;

dh) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “d”, me kusht që i tërë aktiviteti i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, ndaj të cilit zbatohet paragrafi 6, vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një ndërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues, kjo ndërmarrje do të konsiderohet se ka një njësi të përhershme në Shtetin e përmendur në fillim lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, nëse ky person ka dhe zakonisht ushtron në Shtetin e përmendur në fillim një autoritet për të përmbyllur kontrata në emër të ndërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4 që, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin këtë vend fiks biznesi një njësi të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet se ka një njësi të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm për faktin se ushtron biznes në atë Shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti komisionar të përgjithshëm apo çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë në kuadrin e zakonshëm të biznesit të tyre.

7. Fakti që një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon apo kontrollohet nga një kompani që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, apo që ushtron biznes në atë Shtet tjetër (qoftë nëpërmjet një njësie të përhershme apo ndryshe), nuk përbën arsye të mjaftueshme për ta konsideruar njërin kompani njësi të përhershme të tjetres.

## Neni 6

### Të ardhurat nga pasuria e patundshme

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e patundshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia apo pyjet), të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e patundshme” do të ketë kuptimin që i është dhënë në legjislacionin e Shtetit Kontraktues në të cilin është vendosur pasuria në fjalë. Në çdo rast termi do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së patundshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe në pyje, të drejtat ndaj të cilave aplikohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronësinë mbi tokën, uzufukti i pasurive të patundshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse apo të ndryshueshme që jepen si shpërblim për shfrytëzimin, apo të drejtën e shfrytëzimit, të zonave dhe burimeve minerare dhe burimeve të tjera natyrore. Mjetet lundruese dhe avionët nuk do të konsiderohen pasuri e patundshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave nga përdorimi direkt, nga qiradhënia apo përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të patundshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuritë e patundshme të një ndërmarrjeje.

## Neni 7

### Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë Shtet, përveç kur ndërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur aty. Nëse ndërmarrja ushtron biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të taten në Shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i përket asaj njësie të përhershme, në pajtim me dispozitat e paragrafit 2.

2. Për qëllime të këtij neni dhe të nenit 22, fitimet që do t'i përkasin një njësie të përhershme, në secilin Shtet Kontraktues, të cilave iu referohet në paragrafin 1, janë fitimet që mund të pritet t'i bëjnë, në mënyrë të veçantë në marrëdhëniet e saj me pjesët e tjera të ndërmarrjes, nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e pavarur e angazhuar në veprimtari të njëjtë ose të ngjashme në kushte të njëjta ose të ngjashme, duke marrë parasysh funksionet e kryera, mjetet e përdorura dhe rreziqet e supozuara nga ana e ndërmarrjes përmes njësisë së përhershme dhe përmes pjesëve të tjera të ndërmarrjes.

3. Kur, në përputhje me paragrafin 2, një Shtet Kontraktues rregullon fitimet që i përkasin një njësie të përhershme të një ndërmarrjeje të një prej Shteteve Kontraktuese dhe i taton normalisht fitimet e ndërmarrjes që kanë qenë ngarkuar me tatim në Shtetin tjetër, Shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm të shumës së

tatimit të ngarkuar mbi ato fitime, në masën e nevojshme për të eliminuar tatimet e dyfishta mbi këto fitime. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të konsultohen me njëra-tjetrën nëse është e nevojshme.

4. Kur fitimet përfshijnë lloje të të ardhurave që trajtohen veçmas në nene të tjera të kësaj Marrëveshjeje, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

#### Neni 8

##### **Transporti ujor dhe transporti ajror**

1. Fitimet nga veprimtaria e mjeteve lundruese ose avionëve në trafikun ndërkombëtar do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Fitimet nga veprimtaritë, mjeteve lundruese të transportit në ujërat e brendshme do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

3. Nëse vendi i drejtimit efektiv të një ndërmarrjeje detare transportit ose të transportit në ujërat e brendshme, është në bordin e një mjetit lundrues, atëherë ai do të konsiderohet i vendosur në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i qëndrimit të zakonshëm të mjetit lundrues ose, nëse nuk ka një port të tillë, në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është përdoruesi i mjetit lundrues.

4. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një marrëveshje, një biznes të përbashkët apo në një agjenci transporti ndërkombëtare.

#### Neni 9

##### **Ndërmarrjet e lidhura**

1. Kur:

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet e vendosura ose të diktuar midis dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra prej ndërmarrjeve, por që për shkak të këtyre kushteve nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të taten normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje, të atij Shteti – dhe i taton normalisht – fitime për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër

Kontraktues është ngarkuar me tatim në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga ndërmarrja e shtetit të përmendur në fillim nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të ishin ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë ai Shtet tjetër do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit të ngarkuar mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi do t'u kushtohet vëmendje edhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese në rast nevojë do të konsultohen me njëri - tjetrin.

#### Neni 10

##### **Dividendët**

1. Dividendët e paguar nga një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në atë Shtet tjetër.

2. Termi “dividend”, në kuptimin e përdorur në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet, përfshirë aksionet ose të drejtat të tjera, aksionet e minierave, aksionet e themelimit apo të drejta të tjera që nuk përbëjnë kërkesa borxhi, pjesëmarrjen në fitime, dhe të ardhurat nga të drejta të tjera korporative që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit, rezidente e të cilit është kompania që bën shpërndarjen.

3. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të aplikohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur aty dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me këtë njësi të përhershme. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7.

4. Kur një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai Shtet tjetër mund të mos vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga kompania, përveç kur këto dividendë i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues ose përderisa zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me një njësi të përhershme të vendosur në atë Shtet tjetër; subjekt i tatimit nuk do të jenë as fitimet e pashpërndara të kompanisë edhe nëse dividendët e paguar apo fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht në fitime apo të ardhura të realizuara në atë Shtet tjetër.

#### Neni 11

##### **Interesi**

1. Interesi i krijuar në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, interesi i tillë mund të tatohet edhe në Shtetin Kontraktues ku ai krijon dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por, kur pronari përfitues i interesit është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi "interes", në kuptimin e përdorur në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim, dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga obligacionet shtetërore, bonot e thesarit dhe lloje të tjera letrash me vlerë, përfshirë edhe fitimet apo shpërblimet që rrjedhin nga këto obligacione apo bono thesari. Për qëllime të këtij neni, gjobat e ngarkuara për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen interes.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur aty dhe kërkesa e borxhit për të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me këtë njësi të përhershme. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7.

5. Interesi do të konsiderohet se do të krijohet në një Shtet Kontraktues kur paguesi është një rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur një person i cili paguan interesin, qoftë ai rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka një njësi të përhershme në një Shtet Kontraktues në lidhje me të cilën ka lindur borxhi për të cilën paguhet interesi, dhe ky interes mbartet nga ana e kësaj njësie të përhershme, atëherë interesi i tillë do të konsiderohet se është krijuar në Shtetin ku është vendosur njësia e përhershme.

6. Kur për shkak të marrëdhënieve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues të interesit ose ndërmjet të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesit, bazuar në kërkesën për borxh për të cilën paguhet, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa tepricë e pagesave do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 12

##### **Të ardhurat nga e drejta e pronësisë**

1. Të ardhurat nga e drejta e pronësisë që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë Shtet

tjetër. Nëse është kështu, tatimi i ngarkuar nuk do të jetë më shumë se 10 %.

2. Termi "Të ardhurat nga e drejta e pronësisë" në kuptimin e përdorur në këtë nen nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin, apo të drejtën e përdorimit, të çdo të drejte autori në letërsi, për punime artistike apo shkencore, përfshirë filmat kinematografikë, kaseta, videokaseta apo disqe për transmetime radiotelevizive, çdo patentë, markë tregtare, projekt apo model, plan, proces apo formulë sekrete, ose për përdorim ose të drejtën e përdorimit të pajisjeve industriale tregtare apo shkencore, apo për informacione lidhur me eksperiencën industriale, tregtare apo shkencore.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i të drejtave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin krijohen të drejta të autorit, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur aty, dhe e drejta apo pasuria lidhur me të cilën paguhen këto të drejta është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme. Dispozitat e nenit 7 do të gjejnë zbatim në këtë rast.

4. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues dhe midis të dyve dhe personave të tjerë, shuma e të drejtave, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm ndaj shumës së përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa tepricë e pagesës do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 13

##### **Fitimet nga kapitali**

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme, referuar në nenin 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme, që bëjnë pjesë në pasuritë biznesore të një njësie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë njësisë së përhershme (vetëm ose bashkë me ndërmarrjen), mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i mjeteve lundruese, avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar, mjeteve lundruese që operojnë në transportin e ujërave të brendshme, ose i pasurive të luajtshme që i përkasin operimit të këtyre mjeteve të transportit do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin gjendet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve të realizuara nga më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme e vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në atë shtet tjetër Kontraktues.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie të ndryshme nga ato të referuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

#### Neni 14

##### **Të ardhurat nga punësimi**

1. Subjekt i dispozitave të neneve 15, 18 dhe 19, rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi do të taten vetëm në atë Shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna është ushtruar në këtë mënyrë, këto të ardhura të realizuara në këtë mënyrë mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punësimin e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të taten vetëm në Shtetin e përmendur në fillim, nëse:

a) përfituesi është prezent në Shtetin tjetër për një periudhë apo periudha që në total nuk i kalojnë 183 ditë gjatë çdo periudhe 12 - mujore që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës; dhe

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të, një punëdhënësi që nuk është rezident i Shtetit tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme që punëdhënësi ka në Shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, pagesat e kryera lidhur me punën e ushtruar në bordin e një mjeti lundruar, avioni që operohet në trafikun ndërkombëtar, ose në bord të anijes që operohet në transportin e ujërave të brendshme, mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin është vendosur vendi efektiv i drejtimit të sipërmarrjes.

#### Neni 15

##### **Shpërblimet e drejtorëve**

Pagesat e drejtorëve apo shpërblime të tjera të ngjashme, të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozicionin e tij si anëtar i bordit të drejtorëve të një shoqërie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë Shtet tjetër.

#### Neni 16

##### **Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 14, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti

Kontraktues si një argëtues, si artist teatri, kinematografie, radio apo televizioni, ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë Shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist apo sportist nga veprimtari të tilla realizohen jo direkt nga artisti apo sportisti, por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 14, mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në lidhje me të ardhurat e fituara nga aktivitetet e kryera në një Shtet Kontraktues nga artistët apo sportistët në rastin kur vizita e tyre në këtë shtet mbështetet pjesërisht ose tërësisht nga fonde publike të Shtetit tjetër të nënndarjeve të tij politike apo administrative. Në një rast të tillë, e ardhura taten vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilës është personi.

#### Neni 17

##### **Pensionet**

1. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 18, pensionet dhe pagesa të tjera të ngjashme që i paguhen një rezidenti të një Shteti Kontraktues lidhur me punën e tij në të kaluarën do të taten vetëm në atë Shtet.

#### Neni 18

##### **Shërbimet qeveritare**

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues, nënndarje politike, apo administrative atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti, nënndarje apo autoriteti do të taten vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto paga dhe shpërblime të ngjashme do të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet janë kryer në atë Shtet dhe individ është rezident i atij Shteti, i cili (individ):

i) është shtetas i këtij Shteti; ose

ii) nuk bëhet rezident i këtij Shteti vetëm për qëllimin e kryerjes së këtij shërbimi.

2. a) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara nga, apo prej fondeve të krijuara nga, një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti apo nënndarje apo autoriteti administrativ do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, të tilla pensione dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të jenë të taksueshme vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individ është rezident dhe shtetas i atij Shteti.

3. Dispozitat e neneve 14, 15, 16 dhe 17 do të aplikohen ndaj rrogave, pagave, pensioneve dhe shpërblimeve të tjera të ngjashme lidhur me shërbimet e kryera në lidhje me një biznes të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo administrative atje.

**Neni 19**  
**Studentët**

Pagesat e marra nga një student apo praktikantë, i cili është ose ishte menjëherë përpara vajtjes në Shtetin Kontraktues një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në Shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim arsimimi apo trajnimit, për qëllim të jetesës së tij, arsimimit apo trajnimit nuk do të tatohet në atë Shtet, me kusht që të tilla pagesa lindin nga burime jashtë atij Shteti.

**Neni 20**  
**Të ardhurat e tjera**

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk mbulohen nga nenet e mëparshme të kësaj Marrëveshjeje do të tatohen vetëm në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, të ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e patundshme që përcaktohen në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur aty dhe e drejta apo pasuria lidhur me të cilën janë paguar të ardhurat është efektivisht e lidhur me këtë njësi të përhershme. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7.

**Neni 21**  
**Kapitali**

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të patundshme të referuara në nenin 6, i zotëruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe i vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohet në këtë Shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë biznesore të një njësie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohet në atë Shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga mjete lundruese dhe avionë që operojnë në transportin ndërkombëtar dhe mjeteve lundruese që veprojnë në transportin e ujërave të brendshme dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre mjeteve lundruese dhe avionëve do të tatohet vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet.

**Neni 22**  
**Metoda e eliminimit të tatimeve të dyfishta**

Tatimi i dyfishtë do të eliminohet në mënyrën që vijon:

**1. Në Shqipëri:**

a) Kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura ose zotëron kapitale, të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të tatohen në Kosovë, do të lejojë:

i) një reduktim nga tatimi në Shqipëri mbi të ardhurat e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat e paguara në Kosovë; dhe

ii) një reduktim nga tatimi në Shqipëri mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Kosovë.

Megjithatë, ky reduktim, në çdo rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose kapitalin të llogaritur para dhënies së reduktimit që i atribuohet sipas rastit të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në Kosovë.

b) Kur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes, të ardhurat e realizuara në Kosovë ose kapitali i zotëruar në Kosovë nga një rezident i Shqipërisë përjashtohet nga tatimi në Shqipëri, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, Shqipëria merr parasysh të ardhura ose kapitalin e përjashtuar.

**2. Në Kosovë:**

a) Kur një rezident i Kosovës realizon të ardhura ose zotëron kapitale, të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të tatohen në Kosovë do të lejojë:

i) një reduktim nga tatimi në Kosovë mbi të ardhurat e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat e paguara në Kosovë; dhe

ii) një reduktim nga tatimi në Kosovë mbi kapitalin e atij rezidenti, për një shumë të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Shqipëri.

Megjithatë, ky reduktim, në çdo rast, nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit kosovar mbi të ardhurat ose kapitalin të llogaritur para dhënies së reduktimit që i atribuohet sipas rastit të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në Shqipëri.

b) Kur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes, të ardhurat e realizuara në Shqipëri ose kapitali i zotëruar në Shqipëri nga një rezident i Kosovës përjashtohet nga tatimi në Kosovë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti kosovar, merr parasysh të ardhura ose kapitalin e përjashtuar.

### Neni 23 Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk do t'i nënshtrohen ndonjë tatimi apo kërkesë të lidhur me të që të jenë të ndryshme apo më të rënda se sa tatimet apo kërkesat e lidhura me to të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen shtetasit e atij Shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti lidhur me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo asnjërit nga Shtetet Kontraktuese.

2. Personat pa shtetësi që janë rezidentë të një Shteti Kontraktues nuk do t'i nënshtrohen asnjë tatimi në asnjërin Shtet Kontraktues apo ndonjë kërkesë të lidhur me të e cila është e ndryshme apo më e rëndë se sa tatimi dhe kërkesat e ndërlidhura të cilave mund ose iu nënshtrohen shtetasit e Shtetit në fjalë në të njëjtat rrethana, në veçanti në lidhje me banimin.

3. Tatimi i një njësie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë Shtet tjetër sesa tatimi i vjelë ndaj ndërmarrjeve të këtij Shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues ndihma, lehtësime personale apo reduktime personale për qëllime tatimore që i garanton rezidentëve të Shtetit të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familjare që ata kanë.

4. Përrjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 në nenit 9, paragrafit 6 të nenit 11 ose paragrafit 4 të nenit 12, interesat, të drejtat e pronësisë dhe shpërblimet e tjera të paguara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kushte njëjloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të Shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kushte njëjloj sikur ndërmarrja të kishte kontraktuar me një rezident të Shtetit të përmendur në fillim.

5. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është plotësisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në Shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se sa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave u nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit të përmendur në fillim.

6. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, dispozitat e këtij neni do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji dhe përshkrimi.

### Neni 24 Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person konsideron se veprimet e njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mënyrat e ankimimit të parashikuara në legjisllacionin e brendshëm të këtyre Shteteve, ai mund t'ia paraqesë rastin e tij autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues rezident i të cilit është ai ose, nëse çështja ka të bëjë me paragrafin 1 të nenit 23, ai mund t'ia paraqesë atë Shtetit Kontraktues shtetas i të cilit është ai. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga afatet kohore të përcaktuara nga ligji i brendshëm i secilit prej Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Marrëveshjes. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk sigurohet nga Marrëveshja.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri - tjetrin në mënyrë direkte, duke përfshirë këtu dhe ngritjen e komisioneve të përbashkëta të përbëra nga vetë ata apo përfaqësuesit e tyre, me qëllim arritjen e marrëveshjeve reciproke, në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

5. Kur:

a) sipas paragrafit 1, një person i ka paraqitur një rast autoritetit kompetent të një Shteti Kontraktues mbi bazat që veprimet e njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese kanë rezultuar me taksimin e atij personi që nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, dhe

b) autoritetet kompetente nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje për të zgjidhur këtë rast në pajtim me paragrafin 2 brenda dy viteve nga paraqitja e rastit tek autoriteti kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues,

çdo çështje e pazgjidhur që lind nga rasti do të dërgohet për arbitrazh në qoftë se personi e kërkon këtë.



Megjithatë, këto çështje të pazgjidhura nuk duhet t'i nënshtrohen arbitrazhit në qoftë se një vendim për këto çështje tashmë është dhënë nga një gjykatë ose tribunal administrativ i ndonjërit nga Shtetet. Përveç nëse personi i prekur direkt nga rasti nuk pranon marrëveshje të përbashkët që zbaton vendimin e arbitrazhit, ai vendim do të jetë i detyrueshëm për të dy Shtetet Kontraktuese dhe do të zbatohet pavarësisht afateve kohore në legjislacionin e brendshëm të këtyre Shteteve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin për mënyrën e zbatimit të këtij paragrafi me mirëkuptim reciprok.

#### Neni 25

##### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet të tilla të nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose administrimit apo zbatimin e ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi të vëna në emër të Shteteve Kontraktuese, nënndarjeve politike të tyre apo administrative, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë, sipas paragrafit 1, nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij Shteti dhe do t'i ofrohet vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve të referuara në paragrafin 1, apo mbikëqyrjen e këtyre më lart. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ato mund ta nxjerrin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

3. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktues detyrimin:

a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikën administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të ofrojë informacione që ndalohen sipas ligjeve dhe praktikës normale administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të ofrojë informacione që mund të shpalosnin një sekret tregtar, biznesi, industrial, komercial ose sekret profesional apo proces tregtar, ose informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

#### Neni 26

##### **Asistenca për mbledhjen e tatimeve**

1. Shtetet kontraktuese i japin njëra - tjetrës asistencë në mbledhjen e të ardhurave. Kjo asistencë nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të zgjidhin me marrëveshje reciproke mënyrën e zbatimit të këtij neni.

2. Termi "Kërkesa për të ardhura" i përdorur në këtë nen është shuma që duhet të paguhet në lidhje me tatimet çdo lloji dhe përshkrimi të caktuar në emër të Shteteve Kontraktuese, nënndarjeve politike ose administrative të tyre, nëse tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje ose një instrument ku janë palë, dy Shtetet Kontraktuese, si dhe interesat, gjobat administrative dhe shpenzimet e mbledhjes dhe ruajtjes së një shume të tillë.

3. Nëse një pretendim për të ardhura i një shteti kontraktues është i ekzekutueshëm sipas ligjeve të atij Shteti dhe është në pronësi të një personi që, për momentin, sipas ligjeve të atij shteti, nuk mund të pengojë mbledhjen e tij, ai pretendim për të ardhura, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij Shteti, mund të pranohet për qëllimet e mbledhjes nga autoriteti kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues. Pretendimi për të ardhura realizohet nga Shteti tjetër në pajtim me dispozitat e ligjit të tij që zbatohen për zbatimin dhe mbledhjen e tatimeve të veta sikur pretendimi për të ardhura të ishte pretendim i atij Shteti tjetër.

4. Nëse një pretendim për të ardhura i një Shteti Kontraktues është një pretendim në lidhje me të cilin ai Shtet, në bazë të ligjeve të tij, mund të marrë masa ruajtjeje për të siguruar mbledhjen, ai pretendim për të ardhura, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij Shteti, pranohet për qëllimet e marrjes së masave të ruajtjes nga autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues. Shteti tjetër Kontraktues merr masa për ruajtjen në lidhje me atë pretendim për të ardhura në pajtim me dispozitat e ligjeve të tij sikur pretendimi për të ardhura të ishte një pretendim i atij shteti tjetër edhe nëse, në momentin kur zbatohet një masë e tillë, pretendimi për të ardhura nuk është i zbatueshëm në shtetin e parë ose duhet të paguhet nga një person që ka të drejtë të pengojë mbledhjen.

5. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 3 dhe 4, një pretendim për të ardhura që pranohet nga një Shtet Kontraktues për qëllimet e paragrafit 3 ose 4, në atë Shtet, nuk u nënshtrohet kufijve kohorë apo t'i jepet ndonjë prioritet që zbatohet për pretendimin e të ardhurave sipas ligjeve të atij Shteti për shkak të natyrës së tij si i tillë. Përveç kësaj, një pretendim për të ardhura i pranuar nga një Shtet Kontraktues për qëllimet e paragrafëve 3 ose 4, në atë Shtet, nuk ka prioritet të zbatueshëm për atë pretendim të ardhurash sipas ligjeve të Shtetit tjetër Kontraktues.

6. Çështjet në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose shumën e një pretendimi për të ardhura të një Shteti Kontraktues nuk do të sillen para gjykatave ose organeve administrative të Shtetit tjetër Kontraktues.

7. Nëse në një moment, pasi është bërë një kërkesë nga një Shtet Kontraktues sipas paragrafit 3 ose 4 ose para se Shteti tjetër Kontraktues të ketë mbledhur ose dërguar pretendimin për të ardhurat përkatëse Shtetit të parë, pretendimi për të ardhura pushon së ekzistuari:

a) në rastin e një kërkesë sipas paragrafit 3, një pretendim për të ardhura i Shtetit të parë që është i zbatueshëm sipas ligjeve të atij Shteti dhe është i një personi që, për momentin, sipas ligjeve të atij Shteti, nuk mund të pengojë mbledhjen e tij; ose

b) në rastin e një kërkesë sipas paragrafit 4, pretendimi për të ardhura i Shtetit të parë në lidhje me të cilin ai Shtet, sipas ligjeve të tij mund të marrë masa ruajtjeje me qëllim sigurimin e mbledhjes, autoriteti kompetent i Shtetit të parë njofton menjëherë autoritetin kompetent të Shtetit tjetër për këtë fakt dhe, sipas zgjedhjes së Shtetit tjetër, Shteti i parë pezullon ose tërheq kërkesën e tij.

8. Në asnjë rast dispozitat e këtij neni nuk interpretohen sikur vendosin një Shtet Kontraktues para detyrimit:

a) të zbatojë masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën administrative të tij ose dhe Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të zbatojë masa që do të ishin në kundërshtim me politikën publike (rendin publik);

c) të japë asistencë nëse Shteti tjetër Kontraktues nuk ka ndjekur të gjitha masat e arsyeshme për mbledhjen ose ruajtjen, sipas rastit, të zbatueshme sipas ligjeve ose praktikës administrative të tij;

d) të japë asistencë në ato raste kur barra administrative për atë Shtet është dukshëm jo proporcionale krahasuar me përfitimin e marrë nga Shteti tjetër Kontraktues.

#### Neni 27

#### **Anëtarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore**

Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në privilegjet financiare të anëtarëve të

misioneve diplomatike ose posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

#### Neni 28

#### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit në përputhje me kërkesat ligjore të Shteteve Kontraktuese dhe do të hyjë në fuqi pas marrjes së njoftimit të fundit përmes kanaleve diplomatike të Shteteve Kontraktuese se procedurat e brendshme të ratifikimit të marrëveshjes kanë përfunduar.

2. Kjo marrëveshje do të ketë efekt nga 1 janari i vitit që pason atë të hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe nuk do të ketë fuqi prapavepruese.

3. Në ditën kur kjo marrëveshje bëhet efektive, pushon së zbatuari marrëveshja e datës 28 shtator 2004 e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në emër të Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisje në Kosovë për shmangien e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal.

#### Neni 29

#### **Përfundimi**

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në njoftimin me shkrim nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Marrëveshjen, duke dhënë njoftimin me shkrim të përfundimit nëpërmjet kanaleve diplomatike, të paktën gjashtë muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik, pas 5 vitesh të hyrjes në fuqi. Në rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së pasuri efekt zbatimi nga 1 janari i vitit të ri fiskal.

Hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, njësoj autentike, ku secila palë disponon një kopje të tillë.

Bërë në Prishtinë më datë 28 mars 2014.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

|  |                  |
|--|------------------|
|  | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 36 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006